

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7718 E premte 23 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**

Ntë mbledhjen e parë të qeverisë shqiptare ku mora pjesë (7 nëntor), fliste vetëm një individ, kryeministri (KM) i vendit ndërsa të tjerët mbanin ...

Vijon në faqen 20

Nga TAULANT MUKA

Ç'ndodhi në mbledhjen e parë të qeverisë ku unë mora pjesë?



Opinion **Ditës**

Mtë kujtohet nëntori i 22 viteve më parë, i vitit 1996. Fondi Monetar Ndërkombëtar kishte të njëjtin pozicion sikurse e ka edhe sot në raport me qeverinë ...

Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

FMN erdhi, pa iku



Kryeministri Edi Rama viziton në spital policen e plagosur, Ina Nuka

Protesta/ Meta: Jo dhunë, të nisë dialogu

Rama nuk tërhiqet: Ndërtimet prishen. Basha: Do e paguash që dhunove banorët

Kryeministri viziton në spital policen e plagosur: Bëhu gati, do kurohesh në Turqi

Kryeministri Edi Rama është përballur dje me revoltën e banorëve të Unazës jo vetëm në distancë, por edhe fizikisht. Disa prej banorëve që preken nga projekti i zgjerimit të Unazës së Madhe kanë tentuar ta godasin me këpuçe kryeministrin Rama teksa ai dilte nga Spitali i Traumës, pasi kishte vizituar disa nga efektivet e policisë ...

Në faqen 2-5

"LUFTE" PARA KUVENDIT/ EFEKTIVJA 24-VJEÇARE HUMB 2 GISHTAT E DORES

"UNAZA E RE", PLAGOSEN 15 POLICE E PROTESTUES

Banorët tentojnë të hyjnë në sallën e parlamentit, përplasje me policinë. 24-vjeçarja Ina Nuka flet nga spitali: Më ra shashka, doja ta hiqja me dorë



(Në foto) Banorët e Unazës së Re, gjatë një proteste përpara parlamentit. Policia e plagosur, Ina Nuka



MIRATOHET LIGJI

Ndalohen pijet energjike dhe ato me gaz për personat që janë nën 18 vjeç

Në faqen 10

PRESIDENTI

Kuvendi miraton dekretin e Lleshajt. Meta takon Zaev: Maqedonia në NATO

Në faqen 5-6

INTERVISTA

Primo Shllaku: Takimi me Bodlerin më 1968 përmes një libri të shqepur

Në faqen 18-19

"RRISNI BUXHETIN"

Studentët, protestë para Kryeministrisë: Ulni tarifën, janë kushte skandalozë

Në faqen 11

Në faqen 12-13

EKZEKUTIMI



Policia greke vret shqiptarin, akuza: Transportoi drogë nga Shqipëria

Në faqen 8

Sot del në qarkullim libri më i fundit i "Mjeshërit të madh" Bashkim Zeneli, "Miqësi e trazuar"

"Si elektrizoi Inva Mula diplomatë e artistë në Athinë"

"Salla e gurtë e Herodionit oshtiu. Mbi 5000 spektatorë duartrokisnin pa pushim"

NGA BASHKIM ZENELI

Sot del në qarkullim libri më i fundit i Bashkim Zenelit, dekoruar me titullin "Mjeshërit të madh", "Miqësi e trazuar". Greqia në kujtimet e ambasadorit, nga UET press. Një libër që veç historisë së marrëdhënieve



mes dy vendeve, ndërthuret bukur me histori të antikitetit duke u bërë më interesant për lexuesin shqiptar. "Gazeta Shqiptare" po boton një pjesë të librit, i cili nga sot do të jetë në dorë të lexuesit. Në Athinë do të themelohej Akademia nga Platoni ...

Në faqen 12-13

UNAZA E MADHE PROTESTA

Vizita te policët e plagosur, protestuesit tentuan të gjuajnë kryeministrin

E godasin me këpucë, Rama: Gishtat e prerë janë vija e kuqe

"Tërhiquni, ose do të përballeni me ligjin"

Kryeministri Edi Rama është përballur dje me revoltën e banorëve të Unazës jo vetëm në distancë, por edhe fizikisht. Disa prej banorëve që preken nga projekti i zgjerimit të Unazës së Madhe kanë tentuar ta godasin me këpucë kryeministrin Rama teksa ai dilte nga Spitali i Traumës, pasi kishte vizituar disa nga efektivet e policisë, që ishin lënduar gjatë protestës së paradites. Në hyrje të spitalit ai është pritur nga familjarët e protestuesve të lënduar. "Turp, turp, turp", iu drejtuan ata Ramës, ndërsa brohoritnin në kor: "Çfarë bëri ai që e more me polici, more hajdut?! Qeveri e krimi!", iu drejtua një tjetër familjare, Ramës. Por ndërsa ai nisi të jepte mesazhin e tij për mediat, disa nga protestuesit kanë tentuar t'i afrohen, por janë larguar nga forcat e sigurisë.

KËPUCA

Të gjendur përballë forcave të shumta policore, një prej tyre, i cili mësohet se është Flori Protoduari, ka tentuar ta godasë kryeministrin, duke hedhur një këpucë drejt tij. Për fat të Ramës, këpucë nuk ka mbërritur deri tek ai, pasi një prej truporëve i ka dalë para dhe e ka kapur atë. Gjithsesi, Ramës i është dashur të presë disa minuta deri sa të riniste fjalën, pasi protestuesit kanë nisur të bërtasin dhe të hedhin thirrje kundër tij dhe qeverisë. Situata është qetësuar disa me ndërhyrjen e forcave të policisë, të cilat i kanë shoqëruar disa prej tyre me furgonë drejt komisarariatit.

MESAZHI

Pas qetësimit të situatës kreu, i qeverisë ka bërë edhe një herë të qartë se nuk do të tolerohet asnjë tentativë dhune ndaj institucioneve dhe në veçanti ndaj policisë. "Përfytyroni çdo prind, çdo vëlla, çdo motër, çdo të thotë të vijë vajza nga puna, vetëm 24 vjeç me gishta të këputur, pasi ka dalë të kryejë detyrën. Është një situatë që nuk ka ndodhur që nga prishjet e parkut 'Rinia' -", u shpreh Rama. Ai u shpreh se pavarësisht këtyre përpjekjeve, projekti do të realizohet, ndërsa theksoi se gishtat e prerë të efektives së plagosur në protestë ishin vija e kuqe e protestës. "Një parti që merr përsipër të mbrojë zaptues pronash



PARALAJMËRIMI

"Një parti që merr përsipër të mbrojë zaptues pronash kundër interesit publik për të frenuar zhvillimin e një veprë që nuk kanë për ta frenuar dot. Prejra e gishtave është një vijë e kuqe për ata që sot kanë marrë përsipër t'i kundërvihen ligjit. Nuk ka shans që ligji të mos zbatohet njësoj për të gjithë dhe Policia e Shtetit të kthehet në target për kapsolla gurë".

ARSH: Vetëm mbikalimet dhe nënkalimet marrin 75% të lekëve

Në një reagim për mediat, Autoriteti Rrugor Shqiptar nka sqaruar në detaje koston e gjithë projektit të zgjerimit të Unazës së Madhe. Sipas ARSH-së, projekti për objektin "Rehabilitimi i segmentit rrugor Pallati me Shigjeta - sheshi 'Shqiponja'. Lot 1, 2 dhe 3 përfshin një segment prej 2.3 km rrugë të kategorisë A. Rruga sipas ARSH-së do të ketë një korsi emergjence 3m. Gjithashtu, do të jetë e pajisur me trafikndarëse dhe brez të gjelbër në mes. Gjithashtu, rruga do të ketë edhe 4.68 km rrugë e shërbimit 'Kategoria F' me 2 korsi me dy sense 3.5m. Gjithashtu, do të ketë edhe 5 km trotuar me 2.5m gjërësi dhe 5 km korsi biçikletash me 2.5 m gjërësi. ARSH bën me dije se rruga do të ketë edhe disa veprat infrastrukturore inxhinierike si: 2 mbikalime dhe 1 nënkalim të sheshi 'Shqiponja', dy nënkalime të tjera, njëri të Lumi Lana dhe tjetri të zona e 'Astirit'. Gjithashtu, përgjatë rrugës parashikohet edhe një mbikalim tjetër për makinat. Sipas ARSH-së, vetëm veprat e artit infrastrukturore mbikalime/nënkalime në rrugët e kategorisë A dhe ato të kategorisë F në këtë projekt kanë vlerën 4.4 miliardë lekë ose thënë ndryshe 74.7% të totalit të koston. ARSH do të ditë më parë bëri të ditur se duke nisur që nga janari, në këtë segment do të fillojë të zbatohet një plan menaxhimi për trafikun, duke për të lejuar ecurinë e punimeve. Sipas këtij plani, Unaza e Madhe do funksionojë provizorisht me dy dhe 3 korsi për makinat, kjo në varësi të ecurisë së punimeve.



Kryeministri: S'ka shpronësim për zaptuesit, duan 30 mln \$

Ndërsa jashtë Kuvendit banorët e Unazës së Madhe protestonin kundër projektit që i prish shtëpitë e tyre, brenda sallës së seancave plenare kryeministri Edi Rama ka mbajtur një fjalim të gjatë dhe të ashpër, duke i cilësuar protestuesit zaptues profesionistë. Rama tha se opozita po udhëheq protestën më të turpshme në mbrojtje të ndërtimeve të paligjshme kundër interesit publik. Rama deklaroi se banorët nuk do të marrin dëmshpërblim, nëse nuk kanë tituj pronësie apo nëse nuk i kanë pronat e tyre të legalizuara. "Jemi të dënuar ta udhëheqim vendin pa opozitë as dhe kur diskutohet buxheti në Kuvend. Ndërkohë që opozita udhëheq protestën më të turpshme të vendit, në mbrojtje të ndërtimeve të paligjshme kundër interesit publik", deklaroi kryeministri. Ai tha se nëse qeveria do të dëmshpërblente edhe ata që kanë ndërtuar pa leje, duke zaptuar tokat, atëherë do të duhej që nga ana tjetër të kufizonte financimin e disa programeve sociale, siç është edhe ai për bebë. "A ka njeri normal dhe me një minimum morali qytetar që të thotë se këto dhjetëra miliona dollarë s'duhet t'i marrim 30 mijë familje për bebë, por duhet t'i marrim zaptuesit e tokave", u shpreh Rama. Kryeministri, ndërsa i cilësoi si "abuzuesit e Unazës", theksoi se ata kërkojnë mbi 30 mln \$ për të liruuar pronën që nuk është e tyre.




kundër interesit publik, për të frenuar zhvillimin e një veprë që nuk kanë për ta frenuar dot. Prejra e gishtave është një vijë e kuqe për ata që sot kanë marrë përsipër t'i kundërvihen ligjit. Nuk

ka shans që ligji të mos zbatohet njësoj për të gjithë dhe Policia e Shtetit të kthehet në target për kapsolla gurë", - shtoi Rama. Kryeministri përsëriti edhe një herë se ata që kanë shtëpitë me letra do

marrin dëmshpërblim sipas ligjit, ndërsa të tjerët vetëm bonus qiraje. "Ata që kanë letrat e pronës do të dëmshpërblehen siç e parashikon ligji. Ata që janë aty vetëm me një strehë do të marrin

bonusin e qerasë për tri vite. Dhe të tjerët duhet të largohen sa më parë, se nuk do të marrin asgjë. Përkundrazi, sa më shumë i bien ndesh ligjit, aq më shumë do përballen me ligjin".



Bashkëshortja e burrit që qëlloi Ramën: Nuk na tremb as burgu

Nëna e Dorjan Protoduarit, i cili u arrestua paraditen e djeshme nga policia në ambientet e spitalit, si dhe bashkëshortja e Flori Protoduarit që qëlloi kryeministrin Rama me këpucë, Lindita Protoduari, deklaroi mbremjen e mbremjen e djeshme se ata nuk kanë frikë as nga burgu. Lindita Protoduari deklaroi se as ajo, si burri dhe djali i saj nuk i trembet burgut, ndërsa shtoi se Rama nuk do të mundet kurrë t'u prishë shtëpitë banorëve të Unazës së Madhe. "Nuk trembem nga burgu i Edi Ramës që më ka arrestuar djalin dhe burrin. Sa po dal nga serum. Jam një nënë krenare që do luftoj deri në ditën e fundit, se këto shpi nuk ka për t'i prishur, derisa të vdes. Më ka ardhur në spital dhe më ka thënë që nuk kam ardhur për ty. Dhe i kam thënë që e kam për turp të vish tek mua mo kryeministër drogaxhi, mo kryeministër i korruptuar", tha Lindita Protoduari.



"Me kapsolla dhe tymues", Basha: Rama mban përgjegjësi për dhunën ndaj banorëve

Unaza, protestuesit përleshën me policinë para parlamentit

Protestuesit tentojnë dy herë të hyjnë në Kuvend

Valentina Madani

Protesta e djeshme e banorëve të zonës së "Astirit" përpara parlamentit degjeneroi në akte dhune mes protestuesve dhe forcave të rendit. Protesta nisi e qetë, ndërkohë që deklaratat e z.Rama nga salla e Kuvendit se nuk përfitojnë dëmshpërbllim banorët që nuk janë të pajisur me dokumente irritoi protestuesit. Ata tentuar dy herë të hyjnë në Kuvend, çka solli dhe përplasjet. Banorët të mbështetur edhe nga deputetët e opozitës hodhën kapsolla dhe tymues, kur kryeministri Rama mbante fjalën në parlament. Ata po ndiqnin fjalën e kryeministrit Rama në parlament dhe protesta ishte e qetë deri në momentin kur kreu i ekzekutivit përsëriti se për personat pa dokumente nuk do të ketë dëmshpërbllim. "Për ata të Unazës së Re, duhet të jetë shumë e qartë. Kush ka titull pronësie, do të marrë dëmshpërbllimin sipas ligjit dhe do largohet që aty. Kush nuk ka titull pronësie dhe ka vetëm një shtetëzim, do të marrë bonus tri vite qiraje. Kush ka ngrahina të kategorisë së Bashkimit, Kujtimin, Agronin, Ramazanin, të largohet sa më parë dhe të mos na dalë përpara", tha Rama. Kjo deklaratë acaroi protestuesit teksa kërkuan që kryeministri Rama të dalë dhe të bisedojë me ta. Nga hedhja e kapsollave janë lënduar disa efektivë policie, por edhe nga vetë protestuesit pati të lënduar. Pas disa momenteve të dhunshme, në ambientet para godinës së parlamentit u pa të mbërrirë një ambulancë, e cila mori disa efektivë të plagosur. Një punonjëse e policisë humbi gishtat e një rreze dorë nga një prej kapsollave që protestuesit e Unazës së Re hodhën në drejtim të forcave të rendit para parlamentit. Disa herë protestuesit u përleshën me policinë, pasi tentuan të çajmë me forcë gardhin e forcave të rendit. Të plagosur mbetën edhe 3 protestues. Policia njoftoi se 11 protestues janë arrestuar të akuzuar për plagosje të rëndë me dashje, goditje për shkak të detyrës, protestë të paligjshme dhe prishje të rendit. Njëri prej protestuesve u ndalua në ambientet e Spitalit të Traumës.



Protesta e djeshme para parlamentit

LULZIM BASHA

"Nuk njih vija të kuqe ai, vetëm vija të bardha, nga ato që merr me hundë. Vija e kuqe është shkelur kur u ka vënë kryeqe boje shtëpive të këtyre njerëzve në kundërshtim me ligjin për të përligjur vjedhjen 40 milionë eurove. Kjo është e vërteta, të tjerat propagandë. Do të paguajë shtrenjtë edhe për dhunimin e qytetarëve dhe për atë që u ka ndodhur policëve, vajzës së policisë, të cilëve u uroj shërim të shpejtë", tha z.Basha.

"Viktima të babëzisë dhe arrogancës së Ramës"

Shehu, Balliu dhe Spahia vizitojnë policët e plagosur

Deputetët demokratë Tritan Shehu, Bardh Spahia dhe më herët Klevis Balliu ishin dje në Spitalin Ushtrarak, ku vizituan protestuesit dhe policët e plagosur gjatë protestës para parlamentit kundër prishjes pa dëmshpërbllim të shtëpive tek Unaza e Re. Duke uruar për shërimin sa më të shpejtë të tyre, deputetët e PD-së Tritan Shehu dhe Bardh Spahia, të dy me profesion mjekë, shprehën bindjen se stafi i Spitalit Ushtrarak do të bëjë maksimumin për shërimin e tyre. Për deputetët demokratë, si policët e plagosur ashtu edhe qytetarët janë viktima të papërgjegjshmërisë dhe babëzisë së kryeministrit Rama dhe qeverisë së tij. "Vizituan qytetarët dhe policët e plagosur të cilëve u urojmë shërim të shpejtë. Ajo çfarë i bashkon këta



qytetarë dhe policë të plagosur është fakti që janë viktima të papërgjegjshmërisë dhe babëzisë së një kryeministri dhe qeverisë së tij, i cili hedh në rrugë qytetarët e vet, qindra familje me gra, pleq e fëmijë vetëm e vetëm për t'u hapur rrugë tenderave thellësisht korruptivë. Situata e krijuar sot është rezultat i bërjes së syve qorr dhe veshëve shurdh ndaj halleve të këtyre njerëzve për javë e javë të tëra nga kryeministri Rama. Ato njerëz po luftojnë për shtëpitë e tyre, gjënë më të shtrenjtë pas jetës. Nuk ka rrugë tjetër që ky kryeministër t'u ketë lënë atyre qytetarëve. Është kjo papërgjegjshmëri për të cilën po flasim. Nga kryeministri po bëhet një vesh shurdh dhe një sy qorr. Dhe po sjell këto situata", tha z.Shehu. Më herët gjatë drekës, në Spitalin Ushtrarak ishte edhe deputeti Klevis Balliu, i cili vizitoi i pari si protestuesit, ashtu edhe policët e plagosur. Prania e deputetit Balliu në spital përkoj me ndalimin nga policia të një prej protestuesve brenda spitalit, Dorian Prodouarit, i cili në prani të nënës së tij të plagosur u shoqërua me forcë. Ai po shoqëronte nënën, e cila duhet të merrte trajtim mjekësor të specializuar, si pasojë e plagosjes gjatë protestës.



Berisha: Në protestë u zhduk një fëmijë 8-vjeçar, i arrestuan prindërit

Ish-kryeministri Sali Berisha, në një postim në "Face book" shkruan se në protestën e djeshme është zhdukur një fëmijë 8-vjeçar, të cilit i kanë arrestuar dhe prindërit. Berisha duke publikuar një mesazh të një qytetari shkruan se "zhdukët një fëmijë 8-vjeçar i një çifti protestuesish paqësor, që arrestohen nga narkopolicia e Edvin Kristaq Urrejtitjes! "Zhdukët një fëmijë 8-vjeçar i një çifti protestuesish paqësor që arrestohet nga narkopolicia e Edvin Kristaq Urrejtitjes", shprehet z.Berisha. Ai zbardh më tej mesazhin e qytetarit dixhital: "Sipas të dhënave në media dhe në terren është arrestuar një çift që po protestonte krejt paqësisht pa kryer asnjë veprim të dhunshëm kundër shembjes së shtëpisë së tyre dhe më skandalozë është fakti se kanë një fëmijë të mitur 8 vjeç dhe nuk dihet fati i tij fizik as psikologjik".

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

A. Pasuria nr. 26/ 319, e llojit 'truall', vol. 27, fq. 207, zk. 8642, sip. 10.000 m2, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;
 B. Pasuria nr. 26/ 320, e llojit 'truall', vol. 27, fq. 208, zk. 8642, sip. 10.000 m2, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;
CMIMI 49.754.880 LEKË për secilin pasuri; në Total 99.509.760 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 03.12.2018.
 CEL. 068402666 ; 0693262866 .

AKUZAT

Me thirrjet "poshtë qeveria, poshtë qeveria", "nuk na ndalni dot", banorët e "Astirit" bllokuan sërish rrugën pasditen e sotme në Unazën e

Re. Forca të shumta të shumta të policisë vendore dhe FNSH-së ishin në zonë. Në mbështetje të tyre shkoi dhe vetë kreu i PD, Lulzim Basha, së bashku me deputetë të tjerë të opozitës. Basha akuzoi Ramën se po përdor policinë dhe propagandën për të mbuluar vjedhjen 40 milionë eurove me projektin e Unazës së Madhe. Basha akuzoi Ramën si shkak të dhunës së sotme dhe paralajmëroi se do ta paguajë shtrenjtë. Të vetmin fajtor për dhunën mes protestuesve dhe banorëve, Basha gjen kryeministrin Edi Rama, për të cilin tha se nxitu urrejtjen me gjuhën e përdorur në parlament ndaj qytetarëve.

"Njeriu që frymëzoi dhunën me gjuhën e konfliktit është kryeministri i vendit. Edi Rama mban përgjegjësi për dhunën e ushtruar ndaj banorëve dhe do ta paguajë shtrenjtë që ka shkaktuar disa viktima mes banorëve, gra me shtyllën kurrizore të shembur. Ai do të paguajë edhe për gishtat e policës të plagosur në detyrë", u shpreh Basha. Kryedemokrati theksoi se kryeministri vuri përballë policinë me banorët, duke i përdorur për të mbuluar vjedhjen e 40 milionë eurove. "Ky njeri i papërgjegjshëm po përdor sot për të mbuluar vjedhjen prej 40 milionë eurosh, policinë dhe

propagandën për të vendosur policinë dhe popullin përballë, kur në fakt këtu si qytetarë ashtu dhe policia janë në anën e ligjit dhe i vetmi në anën tjetër të antiligjit është Edi Rama që po grabit 40 milionë euro të shqiptarëve. Opozita ishte aty pranë qytetarëve. I çoi aty policët të patrajnuar, kapi kapsollën me dorë. Kush i goditi qytetarët? Dhunën e filloi Edi Rama në Kuvend. I dëgjoje si i trajtoi? Ai është një kryehajdut që përdor sharjet raciste ndaj popullit të tij dhe këtë do ta paguajë rëndë. Policia të jetë në anën e ligjit dhe jo të mbrojë këtë vjedhje të shëmtuar", deklaroi z.Basha.

DHUNA NË PROTESTË SHIFRAT

Policia ka arrestuar në spital Dori Protoduarin, organizatorin e protestës

Bilanci, 12 policë të plagosur dhe dhjetëra protestues të arrestuar

3 persona të lënduar nga radhët e banorëve të Unazës

Ashu siç edhe kishin paralajmëruar dy ditë më parë, protesta e djeshme e banorëve të Unazës së Madhe ka qenë e dhunshme dhe ka prodhuar një bilanc të rëndë të lënduarish nga të dyja palët. Policia ka raportuar se nga radhët e saj mbetën të plagosur 12 policë, ndërsa nga pala tjetër, numri i të lënduarve dhe që morën ndihmë në spital i ka kaluar 5. Ndërkohë që edhe numri i të shoqëruarve në polici ishte gjithashtu i madh. Vetëm gjatë mesditës policia kishte shoqëruar 11 persona, ndërsa ky numër u rrit edhe më tej në orët e pasdites, pas tentativës që disa prej banorëve të Unazës bënë për të goditur kryeministrin të Spitalit i Traumës, apo edhe pas përplasjes që u zhvilluar sërisht në orët e vona tek Unaza.

TË PLAGOSURIT

Në një njoftim për mediat, Policia e Tiranës bëri të ditur se zyrtarisht në protestë kishin mbetur të plagosur 12 efektivë të saj. "Pas përshkallëzimit të protestës përballë godinës së sallave plenare të Kuvendit të Shqipërisë, protestë e cila u përshkallëzua në akte dhune, për pasojë u plagosën 12 punonjës policie, mes tyre dy në gjendje më të rëndë", thuhet në njoftimin e Policisë së Tiranës. Ndërkohë që ajo raportonte për vetëm 3 persona të plagosur nga radhët e protestuesve. Bëhej fjalë për Adelina Shehun, Adem Carën dhe Lindita Protoduarin, të emën e Dorian Protoduarit, organizatorit të protestës. Të gjithë të plagosurit nga të dyja palët u dërguan në spital për të marrë pjekim. Mes të plagosurve në radhët e policisë ishte edhe një nga drejtuesit e Policisë së Tiranës.

TË ARRESTUARIT

Gjithashtu, policia bëri me dije se shërbimet e Policisë Tiranë kanë shoqëruar 11 shtetas. Nga tërësia e veprimeve të para hetimore të kryera nga specialistët për Hetimin e Krimit, nën drejtimin e Prokurorisë u bë arrestimi në flagrancë i tyre për veprat penale "Plagosje e rëndë me dashje", "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe në manifestime të paligjshme", "Prishje e rendit dhe qetësisë publike" si dhe "Goditja për shkak të detyrës". Natyrisht që kjo ishte një shifër para-prake, pasi siç bëri të ditur policia në njoftimin e vet, po vijon puna për identifikimin dhe shoqërimin e personave të tjerë, të cilët gjatë protestës kanë ushtruar dhunë ndaj punonjësve të policisë,



Policia e plagosur dhe në protestë, Ina Nuka

ORGANIZATORI

Gjatë ditës së djeshme patrullat e Policisë së Shtetit arrestuan edhe organizatorin e protestës së banorëve të "Astrit", Dorian Protoduarin. Arrestimi i tij u bë në ambientet e spitalit "Nënë Tereza" teksa kishte shkuar për të vizituar nënën e tij, e lënduar në protestë.

Policia humbet 2 gishtat e dorës nga kapsolla

24-vjeçarja Ina Nuka: Kapsolla më ra në qafë, e hoqa me dorë

Momenti më i vështirë i protestës së djeshme dhe që trishtoi të gjithë opinionin publik ishte plagosja që pësoi efektivja e Policisë së Shtetit, Ina Nuka. Ndërsa qëndronte në rrethim e parë të kordonit të policisë, ajo është dëmtuar rëndë teksa një kapsollë i ka dëmtuar rëndë dorën. Nuk dihet me saktësi se si u dëmtua 26-vjeçarja, por dëmtimi i saj është vërtetë i rëndë, teksa gjaku i ka mbuluar dorën dhe ajo ka nisur të ulërasë nga dhimbjet. Informacionet për dëmtimin e saj janë kontradiktore, pasi demokratët kanë pretenduar se ajo është goditur me kapsollë, që i ka rënë në dorë. Gjithsesi, pamjet e shpërndara edhe në rrjetet sociale janë vërtetë të rënda, ndërsa në orët e vona të mbremjes doli edhe një foto tjetër nga spitali, ku ajo po qëndron për mjekim. Nga



Efektivja e Policisë së Shtetit, Ina Nuka, dje në spital


pamjet gjendja e saj duket e vështirë, teksa një dorë e ka komplet të fashuar, pasi pretendohet se ka humbur 4 gishta, ndërsa dorën tjetër e ka të fashuar pjesërisht në vetëm dy gishtat e fundit. Dëmtimi i saj është bërë edhe pjesë e debates dhe akuzave politike. Kështu, Rama pasi e vizitoi, e konsideroi gishtërinjtë e humbur të Inës si vijën e kuqe të kësaj proteste, ndërsa ish-kryeministri Sali Berisha e ka quajtur atë ndrikull që i shërben qeverisë. Ndaj këtij etiketimi të fundit të Berishës reagoi sërisht kryeministri, i cili e quajti atë "kafshëri".

RRREFIMI

Efektivja e policisë, Ina Nuka në një intervistë për "Top Channel" ka rrëfyer se si ndodhi ngjarja që i mori disa nga gishtërinjtë e dorës. Ajo bën të ditur se lënda plasëse i ka rënë fillimisht në qafë dhe teksa është përpjekur ta heqë, i ka plasur në dorë. "Ishim planëzuar me shërbim të parlamentit për protestën. Situata agravoji dhe turma nisi të shtynte. Isha në rrethim e dytë dhe një nga këto plasëset më ra në trup dhe u mundova ta shmang me dorën e djathtë, pasi e kisha në pjesën e qafës", tregon Muka. Ajo ishte vendosur në rrethim e dytë të kordonit të policisë, kur një shashkë i shpërtheu pranë dorës së djathtë, duke humbur gishtat. Por situata mund të ishte edhe më e keqe, pasi kapsolla i ka rënë fillimisht në trup dhe falë reagimit në kohë, ka mundur të eliminojë pasojat edhe më të rënda.

banorëve të "Astrit", Dorian Protoduarin. Arrestimi i tij u bë në ambientet e spitalit "Nënë Tereza" teksa kishte shkuar për të vizituar nënën e tij, e lënduar në protestë.

Arrestimin e tij është përpjekur ta ndalojë deputeti demokrat Klevis Balliu, i cili gjendej në ato momente në spital për të vizituar të plagosurit.



Kryeministri Edi Rama vizitoi në spital policin Ina Muka. Ai i premtoi se së shpejti ajo do të nisë për të kuruar në Turqi dorën e plagosur

TË ARRESTUARIT PAS PROTESTËS SË DJESHME

- Alban Ahmetcenaj, 36 vjeç.
- P. A., 17 vjeç.
- Fluturim Goleci, 30 vjeç.
- Ruzhdi Daci, 53 vjeç.
- Marsel Villari, 28 vjeç.
- Erjona Dozhani, 30 vjeç.
- Lulzim Dozhani, 45 vjeç.
- Dorian Protoduarin, 30 vjeç (i shpallur më parë në kërkim nga Kom. Pol. nr.6, për veprën penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe në manifestime të paligjshme").
- Ali Nalic, 35 vjeç.
- Amarildo Sinanaj, 30 vjeç.
- Sptati Bilbilj, 31 vjeç.

SHKURTE

Mes të arrestuarve nga policia, edhe një 17-vjeçar

E rëndë ka qenë edhe situata pas protestës së djeshme para Kuvendit. Ndërsa protestuesit kanë nisur të largohen, policia ka nxituar të bëjë ndalimin e personave më të dhunshëm në të. Një prej tyre ishte edhe i riu 17-vjeçar me iniciale P. A. Video e arrestimit të tij bëri xhiro në rrjetet sociale teksa disa policë nuk arrinin ta fusnin brenda në makinën e policisë. Ai kundërshtoi policinë dhe godet me shkelma, ndërkohë që shan me një fjalor të rëndë policët. "Jam vetëm 17 vjeç", dëgjoheshin fjalët e të riut teksa përpjekë që t'u shpëtonte policëve. Babai i tij kërkoi të bindë policët ta lënë se është minoren, por pa rezultat. Ndërkaq, pjesë e kësaj skene janë bërë edhe deputetët e LSI-së, të cilët u ndodhën rastësisht aty. Ata i kërkuan policisë të mos ushtronjë dhunë dhe të lirojnë të riun.

Veliaj: Mbështetje policisë, ky vend nuk kthehet më pas nga salinjtë

Ndaj situatës së djeshme ka reaguar edhe kryebashkiaku Erion Veliaj, i cili përmes një postimi në "Twitter", theksoi se e gjithë Tirana e ndershme dhe e drejtë është në mbështetje të Policisë së Shtetit, ndërsa u ka uruar shërim të shpejtë efektivëve të plagosur. "E gjithë Tirana e ndershme dhe e drejtë është në mbështetje të Policisë së Shtetit e djemve dhe vajzave në uniformë. Shërim të shpejtë komandant Dhimitraq Ziut dhe efektivëve të lënduar! Keni të gjithë solidaritetin e kryeqytetit! Ky vend nuk kthehet më pas nga salinjtë", nënvizon Veliaj. Ndërkohë që në mbremje ka reaguar edhe ish-ministri i Brendshëm, Sajmir Tahiri, i cili gjithashtu ka dalë në mbështetje të forcave të policisë. "Kurrë mos ardhmë më dita kur politika i bie në kurriz policit, kaq dhunshëm sa sot! Njëri e gjymton në rrugë, tjetri i thotë 'ndrikull', tjetri akoma i thotë 'vetë i fute duart te fishekzjarri'. Në krahuat të Ina! Shërim të shpejtë", shkroi Tahiri në mesazhin e tij.



Presidenti: Keqardhje për aktet e dhunshme, u lënduan protestues paqësorë!

Meta, thirrje qeverisë: Dialog me banorët, zgjidhje urgjente

"Vetëpërmbytje, distancohuni nga dhuna"

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Ilir Meta i kërkoi dje qeverisë që urgjentisht të dialogojë me banorët e Unazës për të gjetur një zgjidhje. Meta dënon dhunën e shfaqur në protestën përpara ndërtesës së parlamentit. Presidenti Ilir Meta, u bën apel institucioneve shtetërore të zbatojnë me përpikëri procedurat ligjore dhe kërkon urgjentisht rivendosjen e dialogut me banorët e prekur nga ky projekt për të gjetur një zgjidhje të drejtë. Z.Meta shprehu shqetësimin për aktet e dhunës në protestën e djeshme të banorëve të "Astirit" të prekur nga projekti i ndërimit të Unazës së Re në Tiranë ndërsa apeloj për dialog mes palëve. Presidenti Ilir Meta bën thirrje për vetpërmbytje ndërsa kërkon që palët e përfshira të vendosin një dialog institucional. Presidenti Meta gjen rastin t'u bëj apel sërish institucioneve shtetërore të zbatojnë me përpikëri procedurat ligjore dhe kërkon urgjentisht rivendosjen e dialogut me banorët e prekur nga ky projekt për të gjetur një zgjidhje të drejtë për të gjithë qytetarët dhe interesin publik. "Presidenti i Republikës, Ilir Meta po ndjek me shqetësim dhe vëmendje zhvillimet e protestës së zhvilluar sot para Kuvendit të Shqipërisë nga qytetarët e prekur nga projekti i ndërimit të Unazës së Re në Tiranë. Meta shpreh keqardhjen më të thellë për aktet e dhunshme të shfaqur gjatë kësaj proteste dhe u bën thirrje të gjitha palëve të përfshira që të shmangin çdo përplasje dhe të vendosin sa më parë një dialog institucional në mënyrë që ankesat e banorëve të shqyrtohen duke i dhënë një zgjidhje kësaj situatë. Pasi u njoh me raportimet, se disa efektive të Policisë së Shtetit dhe protestues paqësorë janë lënduar sot para Kuvendit të Shqipërisë, Presidenti i Republikës shpreh keqardhjen më të thellë dhe u uron shërim sa më të shpejtë", thuhet në reagimin e Presidentit. Gjithashtu, kreu i shtetit denoi aktet e dhunshme ndërkohë që tha se nxitësit e dhunës duhet të izolohehen. "Presidenti Meta



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

THIRRJA

"Presidenti Meta gjen rastin t'u bëjë apel sërish institucioneve shtetërore të zbatojnë me përpikëri procedurat ligjore dhe kërkon urgjentisht rivendosjen e dialogut me banorët e prekur nga ky projekt për të gjetur një zgjidhje të drejtë për të gjithë qytetarët dhe interesin publik", - thuhet në reagimin e Presidentit.



Presidenti te monumenti i Skënderbeut në Shkup

Meta-Zaev: Respektimi i të drejtave të pakicave, kyç për paqen

Gjatë vizitës zyrtare në Shkup, Presidenti, Ilir Meta u takua me kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev. Meta e përgëzoi kryeministrin Zaev për përparimin e shënuar nga vendi i tij si dhe vuri në dukje shpresën dhe dëshirën që Marrëveshja e Prespës mes Maqedonisë dhe Greqisë për çështjen e emrit të përfundojë sa më shpejt dhe me sukses. "Është me rëndësi përfundimi me sukses i Marrëveshjes së Prespës. Kjo do të mundësonte jo vetëm anëtarësimin zyrtar të Maqedonisë në NATO, por do të ndihmonte edhe marrjen e një vendimi të favorshëm në qershor për procesin integruar evropian, duke shënuar sukses për marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, paqen dhe stabilitetin e mbarë rajonit tonë." - u shpreh Presidenti Meta. Presidenti theksoi, gjithashtu, se: "Shqipëria është e angazhuar për respektimin e të drejtave të pakicës maqedonase", ndërsa vlerësoi se është me rëndësi bashkëpunimi i qeverive të dy vendeve tona në kuadër të Procesit të Berlinit. Meta dhe kryeministri Zaev theksuan rëndësinë e forcimit të përpjekjeve në rrugën e reformave për çeljen e negociatave qershorin e ardhshëm me Bashkimin Evropian. Gjatë vizitës në Maqedoni, Meta dje bëri një shtetje në Çarshinë e Shkupit, i shoqëruar nga dhjetëra shqiptarë të Shkupit si dhe vendosi kurorë me lule tek monumenti i Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu si dhe tek mozaiku kushtuar ngjarjeve më të lavdishme të kombit shqiptar: Ilir Meta ndau me ndjekësit e tij në Facebook emocionet e forta që përjetoi gjatë vizitës në shkollën "Kruze Krsti?" në Zadar. Shkollë në të cilën sipas të parit të shtetit, Ndre Mjeda e Gjergj Fishta kanë folur shqip.

LSI: Unaza e Re, megahajdutëri

Vasili: Asfalti i Ramës sa dyfishi i floririt, njerëz jini vigjilent!

LSI paralajmëroi dje deklonimin e fakteve të tjera për atë që e quan megahajdutërinë e qeverisë tek Unaza e Re. Kreut i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, e cilësoi provokative dhe të ulët deklarimet e kryeministrit Rama në Kuvend. "Pas deklarimeve provokative, të ulëta për sa i takon nivel shoqëror dhe politik të kryeministrit, i cili u demonstrua sot as më shumë e as më pak, një provokatori ordiner në krizë, pasi lukunia e hajdutëve ndjen që po u preken interesat e tyre dhe tashmë hajdutëria është në sytë e publikut. Ky kryetar i lukunisë së hajdutëve, quhet Edi Rama. S'ka emër tjetër, jam i detyruar dhe të më ndajnë qytetarët, por nuk e përcaktoj dot ndryshe këtë njeri, i cili u ndërron antishitetin në Shqipëri, pa u marrë ende as leje zhvillimit të territorit e të tjera, pasi merr nga KRTSH-ja i Republikës apo Këshilli Kombëtar i Territorit leje, leja merrret në



AKUZA

"Maksimumi i një autostrade të re në SHBA kushton 2.7. Këtyj kryehajduti i bën 19 dhe del e gënjen njerëzit atje", - tha z.Vasili.

datën 20. Kjo është data 20 e lejes", tha z.Vasili. Sipas tij Rama damkos me kryq të kuq shtëpitë e qytetarëve të ndershëm, gjakun dhe djersën e tyre, i trajton ata tamam si nazis kinë dikur dhe ky hajdut dhe i çmendur njëherazi, del dhe vret dhe bën moral me antishitetin e tij. Duke akuzuar qeverinë për vjedhje me rrugët, Vasili tha se asfalti i Ramës kushton dyfishin e floririt. "Maksimumi i një autostrade të re në SHBA kushton 2.7. Këtyj kryehajduti i bën 19 dhe del e gënjen njerëzit

atje. Për të kuptuar se çfarë hajdutërie është, po marr me mirëkuptim dhe po huazoj një përlllogaritje shumë të bukur të bërë nga një përfaqësues i ndëruar i Shoqërisë Civile, z. Edi Shabani, i cili thotë: Një unazë floriri 6 cm kushton deri në 500 euro. 6 cm asfalt me çmimet e Edi Ramës kushton 1092 euro. Dyfishin e floririt na kushton asfalti i Edi Ramës. Këto janë shifrat, nuk janë të opozitës, nuk janë të Petritit, janë atje", akuzoi Vasili.

dënon aktet e dhunshme dhe u bën thirrje të gjitha palëve të distancohen menjëherë nga dhuna dhe të bëjnë maksimumin për të shmangur konfliktin dhe gjuhën së forcës së përdorur në këtë çështje. Meta gjen rastin t'u bëj apel sërish institucioneve shtetërore të zbatojnë me përpikëri procedurat ligjore dhe kërkon urgjentisht rivendosjen e dialogut me banorët e prekur nga ky projekt për të gjetur një zgjidhje të drejtë për të gjithë qytetarët dhe interesin publik", -thuhet në reagimin e kreu të shtetit. Gjithashtu, Presidenti i Republikës i bën thirrje politikës të tregohet e kujdesshme dhe të japë mesazhe bashkëpunimi e dialogu, ndërkohë që nxitësit e dhunës duhet të izolohehen.

ish institucioneve shtetërore të zbatojnë me përpikëri procedurat ligjore dhe kërkon urgjentisht rivendosjen e dialogut me banorët e prekur nga ky projekt për të gjetur një zgjidhje të drejtë për të gjithë qytetarët dhe interesin publik", -thuhet në reagimin e kreu të shtetit. Gjithashtu, Presidenti i Republikës i bën thirrje politikës të tregohet e kujdesshme dhe të japë mesazhe bashkëpunimi e dialogu, ndërkohë që nxitësit e dhunës duhet të izolohehen.

ish institucioneve shtetërore të zbatojnë me përpikëri procedurat ligjore dhe kërkon urgjentisht rivendosjen e dialogut me banorët e prekur nga ky projekt për të gjetur një zgjidhje të drejtë për të gjithë qytetarët dhe interesin publik", -thuhet në reagimin e kreu të shtetit. Gjithashtu, Presidenti i Republikës i bën thirrje politikës të tregohet e kujdesshme dhe të japë mesazhe bashkëpunimi e dialogu, ndërkohë që nxitësit e dhunës duhet të izolohehen.

KUVENDI VOTIMI

Pas 10 orë diskutime, mazhoranca ka votuar e vetme buxhetin dhe paketën fiskale

Kuvendi miraton buxhetin 2019, Ahmetaj: Ulim borxhin publik

Vitin e ardhshëm parashikohet rritje ekonomike me 4.3%

Pas gati dhjetë orë diskutime, mazhoranca e vetme ka votuar në parim buxhetin e shtetit dhe paketën fiskale për vitin 2019. Mazhoranca ka mundur të sigurojë 77 vota dhe t'i hapë kështu rrugë diskutimit të ligjeve financiare edhe nën përmirësime. Ndërkohë që duke bërë edhe prezantim të detajuar të buxhetit të vitit të ardhshëm, ministri i Financave, Arben Ahmetaj është shprehur se ai vijon të mbështesë rritjen ekonomike të vendit, si dhe konsolidimin fiskal, duke ulur më tej barrën e borxhit publik për biznesin dhe qytetarët. Ahmetaj ka theksuar se nëpërmjet këtij buxheti dhe paketës fiskale, rritja ekonomike për vitin e ardhshëm parashikohet në nivelin 4,3%, çka pritet të forcohet më tej në vitet 2020 dhe 2021. "Raporti i borxhit publik ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto do të ulet 66,9 në fund të vitit 2018, duke iu referuar borxhit neto dhe 64,9 në vitin 2019", u shpreh ministri i Financave.

PUNËSIMI

Më tej, ai theksoi se ky buxhet do të sjellë edhe më shumë punësim. "Rritja domethënëse ekonomike e parashikuar për vitin 2019 krijon më shumë punësim me hapjen e mbi 30 mijë vendeve të reja të punës të planifikuara, duke rezultuar në rënien e nivelit të papunësisë nën 12% të forcës aktive për punë në vitin 2019, krahasuar me 12,9% që planifikohet mesatarja e këtij viti", tha Ahmetaj. Ai gjithashtu theksoi se të ardhurat buxhetore në fund të vitit 2018 pritet të jenë 458,2 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2017 parashikohet një rritje prej 6,5% ose 27,8 miliardë lekë, duke kapur nivelin 27,8% të Prodhimit të Brendshëm Bruto nga 27,7 që ishim në 2017. "Rritja me 0,1% e kontributit të të ardhurave të buxhetit të shtetit në raport me Produktin e Brendshëm Bruto për vitin 2018 është një tregues i rëndësishëm i përmirësimit të performancës së mbledhjes së të ardhurave, në kuadër të reformës së konsolidimit të financave publike", shtoi Ahmetaj. Ai bëri të ditur se shpenzimet e personelit janë planifikuar në masën 80,6 miliardë lekë për vitin 2019, çka përveç financimit të plotë të kostos aktuale të administratës publike, mbartin gjithashtu edhe politikën e rritjes së pagave për sektorin e shëndetësisë, arsimit, mbrojtjes, sistemit penitenciar dhe punonjësit e përfaqësive diplomatike. "Vlen të theksohet se nga kjo rritje e konsiderueshme e pagave përfitojnë 4650 mjekë, 13765 ndihmësmjekë, pra infermierë, 35783 mësues, 6.800 ushtarake, 3559 efektive të policisë së burgjeve dhe 308 diplomatë", u shpreh ministri.

RUGËT

Ministri bëri të ditur se infrastruktura do të përfitojë fonde të konsiderueshme më rreth 2,8% të Prodhimit të



BUXHETI

- Borxhit publik ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto do të ulet 64,9%.
- Rritja ekonomike 4.3%.
- Do krijohen 30 mijë vende të reja pune.
- Të ardhurat buxhetore, 458.2 miliardë lekë.
- Ulja e normës së tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%.
- Rritja e kufirit të pagës që tatohet me 23% nga 130 mijë lekë në 150 mijë lekë.
- Shpenzimet buxhetore do të jenë 519,4.
- Shpenzimet e personelit 80,6 miliardë lekë.



Tryeza e djeshme e opozitës për buxhetin 2019

PUNËSIMI

"Rritja domethënëse ekonomike e parashikuar për vitin 2019 krijon më shumë punësim me hapjen e mbi 30 mijë vendeve të reja të punës të planifikuara, duke rezultuar në rënien e nivelit të papunësisë nën 12% të forcës aktive për punë në vitin 2019, krahasuar me 12,9% që planifikohet mesatarja e këtij viti".

Lleshaj duhet tashmë që të betohet para Metës

Kuvendi votoi dekretin e Metës për Lleshajn

Kuvendi gjatë seancës së djeshme plenare, në fund të të gjitha diskutimeve ka miratuar edhe dekretin e Presidentit të Republikës, Ilir Meta për emërimin e ministrit të Brendshëm, Sandër Lleshajn. Dekreti është miratuar me 77 vota por, ndërsa opozita nuk ishte e prangishme në sallë. Me këtë votim Kuvendi i hap rrugë betimit të Lleshajt para presidentit, para se ai të marrë zyrat detyrë të ministrit të Brendshëm. Gjashtë ditë më parë Meta dekretoi Lleshajn ministër të Brendshëm pas refuzimit herën e parë. Sandër Lleshaj iu hap rruga e emërimit si ministër i Brendshëm kur Presidenti i Republikës firmosi për lirimin e tij si gjeneral gjatë e një funksion që e



bënte Lleshajn të papajtueshëm kushtetutshmërisht me postin e ministrit të Brendshëm. Më lirimin e tij si gjeneral, një kërkesë publike edhe nga kryeministri Rama, Meta i hapi rrugë dekretit të Sandër Lleshajt, emri i të cilit u kthye në një krizë institucionale. Tashmë Sandër Lleshaj duhet të presë kthimin e Presidentit të Republikës nga Maqedonia për të bërë betimin dhe marrë zyr-

tarisht detyrën e ministrit të Brendshëm. Gjithsesi, ai vazhdon të drejtojë Ministrinë e Brendshme si zëvendësimin, ndaj edhe akti i betimit dhe marrjes së detyrës si ministër nuk do të ndryshojë gjë nga ana e funksionimit të ministrisë. Ai do të zëvendësojë në këtë post, ish-ministrit e Brendshëm, Fatmir Xhafaj, i cili dha dorëheqjen gati 3 javë më parë.

SHKURTE

Manastirliu: 580 mijë qytetarë përfitojnë nga investimet

Me investimet për rehabilitimin e 100 qendrave shëndetësore me buxhetin e vitit 2019 do të përfitojnë drejtëpërdrejt 580 mijë qytetarë". Kështu deklaroi ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu në seancën parlamentare për buxhetin e vitit 2019. Ajo tha se do të investohet për fuqizimin e shërbimit përsonor, duke ofruar shërbim me cilësi afër vendbanimit të qytetarëve. "Infrastruktura e përshtatshme, programi i kontrollit mjekësor për çdo qytetar në qendrën e tij shëndetësore si dhe paketa e barnave të rimbursueshme për çdo të sëmurë kronik, qoftë ky i siguruar ose jo, me një financim që edhe për 2019 do të jetë 10 miliardë e 400 milionë lekë - janë hapa konkretë drejt mbulimit shëndetësor universal", tha Manastirliu. Ajo bëri të ditur se vetëm gjatë vitit 2018 po investohet për rehabilitimin e 80 qendrave shëndetësore në të gjithë vendin. Me buxhetin e vitit 2019 investohet në 100 qendra shëndetësore dhe pika ambulancash, si pjesë e programit kombëtar të rehabilitimit të 300 qendrave shëndetësore në këtë mandat qeverisës.

Ditmir Bushati: 2019-ta, vit i rëndësishëm për integrimin

Nga foltorja e Kuvendit, ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati tha se buxheti i vitit të ardhshëm pasqyron më së miri edhe objektivat e Shqipërisë për politikën e jashtme gjatë vitit 2019. "Buxheti gjithashtu reflekton qartësisht politikën tonë të jashtme, pasi viti 2019 është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë për procesin e integrimit. Ky buxhet konfirmon përpjekjet e vazhdueshme të vendit në përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare. Do të kemi një rritje në fushën e mbrojtjes dhe kjo është dëshmi e reformimit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë. E kam fjalën për aspirimin tonë që të jemi drejtues të OSBE në 2020. Vitin e shkuar bëmë dy mbledhje të qeverive, përkatësisht për të detajuar projektet ndërkufitare. Do të vijojmë planin edhe për vitin 2019 për të luajtur rolin konstruktivitetit", tha ai.

Njoftim për shitje me ankand të dytë

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenin 568, 577e vijues të K.Pt.C do të zhvillojë ankandin e dytë për pasurinë e palës debitore B Kamberaj dhe L Kamberaj. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga:

- "Trulli" - Godinë tre kateshe - me numër pasurie 14/283 ne Z.K Nr.8602, volumni 35, faqe 144, truall 300 m², sipërfaqe e katit perche 117,9 m² ne Lagjen 10 Korriku
- Ankandi i dytë i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 6.272.000 Lekë.
- Ankandi gjendet i hapur 30 dite dhe do të zhvillohet në datën 14.12.2018 në orën 15:00 në Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5. Ofertuesit duhet të tërheqin dokumentacionin të kontaktojnë me shoqërinë si dhe mund të vizitojnë faqen WEB www.powerjustice-al.com.

Njoftim për shitje me ankand

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenin 567, 568 të K.Pt.Cive ka shpallur shitjen me ankand të parë për pasurinë e palës debitore, hipotekuse dhe palës dorëzuar:

- "Toka Aje" nr. Z. K. 1987 me numër pasurie 3038 Volumni 19 Faqe 71, me sipërfaqe 1000 m² me çmim fillestar prej 12.520 Euro
- "Toka Aje" nr. Z. K. 1987 me numër pasurie 4056 Volumni 11 Faqe 92, me sipërfaqe 1730 m² me çmim fillestar prej 12.640 Euro
- "Toka Aje" nr. Z. K. 1987 me numër pasurie 2573 Volumni 15 Faqe 239, me sipërfaqe 2.000 m² me çmim fillestar prej 122.640 Euro
- Ankandi gjendet i hapur për 15 ditë dhe do të zhvillohet në datën 06.12.2018 prej orës 15:00, pranë selisë në Bulevardi "Gjergj Fishta" Pall. i Shoqërisë "Gora" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5. Ofertuesit mund të kontaktojnë me sh "Power & Justice"(P&J) sh.p.k dhe vizitojnë faqen WEB www.powerjustice-al.com.



Kreu i opozitës prezantoi dje alternativën e PD-së për buxhetin e vitit 2019

Basha: PD, reduktim të taksave dhe hapje të vendeve të punës

Berisha: Vendi qeveriset nga një kriminel psikik

Valentina Madani

Opozita e bashkuar nuk ishte dje e pranishme në seancën plenare për të kundërshtuar buxhetin e vitit 2019 të sjellë në parlament nga maxhoranca. Por paralelisht me parlamentin, ashtu si ishte njoftuar thirr një seancë paralele me grupe interesi, që preken drejtpërdrejt nga buxheti i sjellë nga shumica. Opozita u mbledh dje në hotel "Tirana" për një bashkëbisedim për buxhetin. Nënkryetarja e Komisionit të Ekonomisë, Jorida Tabaku, drejtoi takimin në të cilin morën pjesë shoqata të biznesit, biznesmenë, grupe interesi, fermerë, pronarë dhe përfaqësues të ish-të përndjekurve politikë. Gjatë tryezës së opozitës së bashkuar, kreu i PD-së Lulzim Basha i dha përgjigje akuzave të kryeministrit, duke e quajtur qëndrimin e tij, si të një "llaxoreje në parlament". "Sot kemi bërë një përpjekje titanike për t'i ikur tallavës që imponon një kryeministër i dështuar që nuk i ka mbetur gjë tjetër veçse të flasë nga foltorja e parlamentit si llaxore. Prandaj nuk mund të jemi në atë parlament, sepse ai sot nuk ka thënë asgjë as për hallat e njerëzve, as për problemet e njerëzve, as për zgjidhjet, është tallur nga fillimi deri në fund. Përtej patologjisë psiqiatrike që është domeni i mjekëve në këtë sallë, dua të them që unë refuzoj si kryetar i opozitës ta zbres nivelin e debatit publik në nivelin prej halabaku me të cilin flet Edi Rama për të fshehur dështimin total të qeverisjes së tij", deklaroi z.Basha.

BUXHETI 2019, ALTERNATIVA E PD-SË SIPAS Z.BASHA

- Alternativa e PD nuk është një tufë premtimesh, por një plan solid për të rindëzuar motorët e fikur të ekonomisë, të rikthejë besimin e investitorëve vendas e të huaj.
- 9% taksë e sheshtë, e domosdoshme si taksë konkurruese në Ballkan për të thithur investime që krijojnë vende pune.
- Për biznesin e vogël ngritja e kufirit të xhiros në 120 milionë lekë në vit dhe vendosja e pullës fiskale në mjediset e jashtme të biznesit. Vendosja e kufirit me ligj për taksat e pushtetit vendor. Në Tiranë janë 7- fishuar.
- Eliminimi të menjëhershëm të taksës së qarkullimit + taksës së karbonit = 314 lekë.litër më lirë.
- Rikthimi i fashave mbrojtëse të energjisë për shtresat në nevojë dhe për prodhuesit. Energjia është një nga piramidat më kriminale të ekonomisë.
- Në qeverinë e PD-së të ardhurat nga taksat e shqiptarëve nuk do të shkojnë për koncesione korruptive. Secili prej tyre do të anulohet sipas ligjit Antimafia.
- Nuk ka për të falimentuar Shqipëria për të paguar 15 kontrata korruptive. Qeveria e PD nuk do të paguajë asnjë qindarkë për to. Këto para do të shkojnë për prioritetet tona të zhvillimit.
- Në bujqësi 100 milionë euro subvencione për fermerët, 50 milionë euro për investime në infrastrukturë.
- Për të realizuar alternativën e PD, duhet të realizohen 3 synimet kryesore të opozitës: vetingu i politikanëve, platforma antimafia, dekriminalizimi i zgjedhjeve.
- Ftoj qytetarët t'i bashkohen alternativës sonë për rrugëdalje nga kriza, për të rikthyer legjitimitetin qeverisjes. Është beteja ekzistenciale për një Shqipëri të mundësive për të gjithë.

MARK CRAWFORD
"Shqipëria duhet të jetë konkurrenë me rajonin nga pikëpamja e taksave, nëse ka taksë dividenti 0 në 5 s'jemi konkurrenë. Përndryshe edhe shqiptarët do shkojnë të investojnë në Shkup e Prishtinë. Duhet të përmbyllet harta e pronësisë që të dimë ku do investojmë e ku jo", tha kreu i Dhomës Amerikane të Tregtisë.

planit tonë ambicioz të investimeve", deklaroi kreu i PD-së. Basha ripërsëriti qëndrimin se pas ardhjes në pushtet qdo tender koncesion e PPP korruptive do të anulohet. Gjatë fjalës që ka mbajtur në këtë mbledhje, ish-kryeministri Sali Berisha apeloj për largimin sa më parë të qeverisë "Rama", dhe sipas tij rruga e vetme për t'i larguar është përballja. "Vendi qeveriset nga një kriminel psikik... Nuk ka gjë më të rëndësishme se buxheti për një popull, sesa paketa fiskale për biznesit, por nëse nuk largohet organizata kriminale që quhet qeveri, ata që blejnë politikanë, blejnë amendamente... nuk duhet të kemi asnjë iluzion duhet të përballemi me këtë qeveri. Rruga e vetme është përballja, sa më shumë të kalojë kjo aq më të lartë do ta paguajmë në vijim", deklaroi z.Berisha.

AGRON DUKA

"Bujqësia është sektor jashtëzakonisht i vështirë prandaj s'ka edhe shumë PPP. Duke qenë kështu, e gjithë bota e subvencionon qeverinë, kurse te ne subvencionimi është vetëm 20 mln euro. Një fond i pamjaftueshëm që s'pasqyron rritje. Kjo shifër është 1 km rrugë me koston e Rilindjes", deklaroi ish-ministri i Bujqësisë.

Biznesi: Opozita të ishte në parlament për buxhetin

Opozita zgjodhi dje që debatimin për buxhetin e vitit 2019 të mos e bëjë në Kuvend, por disa metra larg sallës së parlamentit, në një nga hotelet në qendër të kryeqytetit. Por biznesi, i cili ishte ftuar në këtë bashkëbisedim, i sugjeroi që argumentet t'i balancojë me maxhorancën në komisione dhe sallën e Kuvendit. "Opozita duhet të ishte e pranishme në komisione dhe parlament, ku diskutohet buxheti dhe pastaj të ikte dhe të digjte edhe mandatet po të donte", tha Gjergj Buxhuku, kryetar i Konfindustrias. Në takimin me opozitën e bashkuar biznesi i vogël paralajmëroi protesta lidhur me vendimin e qeverisë për ndërrimin e kasave fiskale.

Mima: Qeveria korporatë që vjedh sipas rregullave të veta

Deputeti demokrat Flo rion Mima denoncoi dje tentativën e Edi Ramës që nëpërmjet një buxheti prej 13,7 miliardë eurosh të tjetërsojë krejtësisht asetet kryesore të ekonomisë shqiptare. "Qeveria po bëhet gati të koncesionojë 13,7 miliardë euro, thotë Mima. Ajo synon të ngrejë një korporatë publike që synon tjetërsimin e pronave publike. Që të jetë e lirë, qeveria ka parashikuar bile që korporata, gjatë punës së vet për privatizimet, nuk do të ndjekë rregullat e njohura të ankandit, por do të veprojë me rregulla të miratuara nga bordi. Pra, një gjetje artistësh. Ky do të jetë buxheti i fundit i kësaj qeverie me sa duket", theksoi deputeti Mima.

nxjerrë nga xhepat e shqiptarëve", theksoi z.Basha. Sipas tij, ky buxhet i propozuar nga qeveria e Edi Ramës nuk është gjë tjetër, por thjesht një legjitimues i vjedhjes. Ai prezantoi dhe disa nga pikat, të cilat ofron alternativa e PD-së për atë që ai e quan rimëkëmbjen e ekonomisë. "Politika jonë fiskale ka vetëm një synim: T'i ndezë motorët e fikur të ekonomisë. Të rikthejë be-

simin e biznesit të vogël, sipër-marrjen në tërësi të investitorëve të huaj dhe të konsumatorëve tek burimet e pashtershme të ekonomisë shqiptare që sot kontrollohen nga një grusht njerëzish. Platforma dhe plani ynë është solid, i kalkuluar që, nga njëra anë, të japë këtë nxitje maksimale dhe nga ana tjetër, të krijojë mjaftueshëm të ardhura për t'u përgjigjur si sfidave sociale, ashtu edhe

Tabaku: 1.9 miliardë euro taksa të rritura në 5 vite

N/kryetarja e Komisionit të Ekonomisë dhe deputetja Jorida Tabaku, deklaroi në bashkëbisedimin për buxhetin 2019 me katastrofiku i 28 viteve. "Legjitimim zhatvjen dhe vjedhjen me ligj të shqiptarëve dhe pasuron një grusht oligarkësh dhe qeveritarësh", tha z.Basha. Ai e etiketoi atë model të varfërimit të shqiptarëve, korupsionit dhe pasurimit të oligarkëve të lidhur me pushtetin. "Buxhet që vjedh njerëzit dhe pasuron të pasurit, model klientelist dhe i korruptuar. Ka rrit çmimet, taksat energjinë, 97% e shqiptarëve paguajnë me shumë se para 5 vitesh dhe shifrat janë 1.9 miliard euro më shumë të



"Rilindjes", e cila u ka shërbyer një grushti njerëzish dhe ka futur duart thellë në xhepat e 99% të qytetarëve. "Në 5 vjet janë bërë 60 ndryshime në ligjet fiskale, 60 herë Edi Rama ka futur duart në xhepat e biznesit dhe qytetarëve, 60 herë ka ndryshuar ligjet pa ju pyetur (biznesin), duke ju gjobitur, duke ju rritur ngarkesën fiskale. Sot është fakt se, në 5 vjet, kemi 1.9 miliardë euro taksa të rritura prej të cilave, 640 milionë euro janë rritur taksa kombëtare dhe të qarkullimit, 650 milionë euro janë rritur akcizat dhe 450 milionë euro është rritur tatim-fitimi", tha zj.Tabaku.

Shoqëria përparimtare JUSTITIA

Shoqëria përparimtare JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shënjën e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vene hipoteke NBG BANK, me këto të dhëna:

Trauili Zk 3064 nr. pasurie 802/1 vol.2 fq.240 94m2 ndertes 250m2. në pronësi të Ali Ibrahim Alushi ndodhur në adresën Prush, Tiranë.

Çmimi me të cilin fillon ankandi është në vlerën 12.000 (dymbëdhjet mijë) EUR.

Ankandi zhvillohet në datën 05.12.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor me Adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Palli. 21.Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890 CEL. 0693177499.

TRAFIKU I DROGES ARRESTIMET

Operacioni në Visani të Janinës, në kërkim edhe katër shqiptarë të tjerë

Trafikantët përplasen me armë me policinë greke, vritet shqiptari

Transportonin marijuanë dhe heroinë nga Shqipëria në vendin fqinj, plagoset edhe një efektivi grek

Arbër Sulo

GREQI

Një shqiptar ka mbe tur i vrarë dhe një polic grek është plagosur në fshatin Visani, në zonën e Janinës. Ngjarja ka ndodhur pas një shkëmbimi me armë zjarri mes disa shqiptarëve që po transportonin drogë nga Shqipëria drejt vendit fqinj dhe policisë greke. Mësohet se gjithçka ka ndodhur rreth orës 17:00. Sipas burimeve nga pala greke, një grup shqiptarësh janë pikasur duke transportuar sasi marijuane dhe heroine. Menjëherë, forcat policore greke janë vënë në ndjekje të tyre, por pohohet se trafikantët shqiptarë, emrat e të cilëve nuk bëhen me dije kanë hapur zjarr me breshëri kallashnikovë ndaj tyre. Policia greke është kundërpërgjigjur, ndërsa si pasojë e shkëmbimit të zjarrit ka mbetur i vdekur në vend një shqiptar, ndërsa është plagosur edhe një efektivi grek. Ndërkaq, burime nga policia e vendit fqinj pohuan se në vendin e ngjarjes janë gjetur dhe sekuestruar dhjetë çanta me lëndë narkotike, ndërsa mendohet se bëhet fjalë për një sasi rreth 100 kg marijuane. Gjithashtu, në vendngjarje janë gjetur edhe dy kallashnikovë, me të cilët qëlluan trafikantët shqiptarë. Nisur nga situata e krijuar, forcat policore greke kanë rrethuar të gjithë zonën e Pogonit në Janinë, ndërsa kanë nisur operacionin për arrestimin e katër shqiptarëve të tjerë. Sipas policisë së shtetit fqinj, trafikantët po tentonin të hynin në Shqipëri. Policia greke ka vënë në gadishmëri gjithë forcat kufitare në Janinë dhe Igumenicë, ndërsa pritet të mbërrijnë në vendngjarje dhe forcat speciale të EKAM. Vrasja e shqiptarit pasditen e djeshme mendohet të jetë një formë hakmarrjeje e policisë së shtetit fqinj, pas



Operacioni në Janinë

DROGA

Burime nga policia e vendit fqinj pohuan se në vendin e ngjarjes janë gjetur dhe sekuestruar dhjetë çanta me lëndë narkotike, ndërsa mendohet se bëhet fjalë për një sasi rreth 100 kg marijuane. Gjithashtu, në vendngjarje janë gjetur dhe sekuestruar edhe dy kallashnikovë, me të cilët qëlluan trafikantët shqiptarë. Nisur nga situata e krijuar, forcat policore greke kanë rrethuar të gjithë zonën e Pogonit në Janinë, ndërsa kanë nisur operacionin për arrestimin e katër shqiptarëve të tjerë.

Disa nga të arrestuarit, me origjinë shqiptare Kokainë nga Shqipëria drejt Italisë, kapen 32 trafikantë të 3 organizatave kriminale

ITALI - Autoritetet italiane pas një operacioni kundër narkotikëve kanë arrestuar 32 persona, të cilët merreshin me trafikim të kokainës kryesisht nga Shqipëria drejt Breshias. Operacioni i ndërmarrë nga Guardia di Finanza ka vijuar kontrollat dhe arrestimet të mërkurës si dhe mëngjesin e ditës së djeshme. Grupi i shpartaluar ishte pjesë e një rrjeti ndërkombëtar të trafikut të lëndëve narkotike. Këta trafikantë janë pjesë e tri organizatave të ndryshme kriminale të specializuara në tregtimin e drogës në



disa vende të botës. Disa prej të arrestuarve janë me origjinë shqiptare, me bashkëpunëtorë natyrisht nga Italia dhe Breshia. Ky operacion ka nisur prej ditësh dhe deri tani kanë përfunduar në pranga mbi 50 trafikantë, janë konfiskuar 130 kg kokainë si

dhe janë sekuestruar një numër i madh i pasurive të paluajtshme në Itali. Pjesë e sekuestrimit ka qenë edhe një pikë shitjesh të makinave, e cila dyshohet se funksiononte me paratë e drogës dhe që kontrollohej prej të arrestuarve.

Njoftim shitje me ankand

Shoqëria përmbarimore "AA Bailiff" shp, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme, Trulli 128 m² dhe ndërtesë 81 m², me Nr. pasurie 2/339, ZK 8511, vol. 15, fq. 127, në pronësi të Cemal Mahmut Shkora e regjistruar në ZVRRP Durrës.

Cmimi i ankandit të tretë është EUR 40,118 (dyzetë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë euro).

Ankandi zhvillohet dit. 03.12.2018, ora 16.00 në adresën Rruga e Kavajës, Ndërtesa 27, Hyrja 1, Kati i III-të, Tiranë.

Kontakt: cel. 0688012846, ose në adresën e email: aabailiff@gmail.com.



Arrestimet gjatë operacionit antidrogë, të koduar "Uraka 2"

SHKURTE

Vdekja e 3-vjeçares në spitalin e Beratit, gjykata: 2 vite shërbim prove për mjekun

BERAT - Gjykata e Beratit dënoi dhe me 1 vit burg mjekun Shpresa Karkanjozi, e cila akuzohej për "mjekim të pakujdesshëm", që solli vdekjen e një fëmije 3 vjeçe në Repartin e Pediatrisë. Ngjarja në fjalë ndodhi më 23 janar të vitit 2017. Mësohet se pas pretendës së kërkuar nga prokurori Dritan Gripshi më 7 nëntor për dënimin me 4 vite burgim për mjekun, gjykata dëgjoi dhe mbrojtjen e avokatit dhe vetë të pandehurës dhe pasi u tërhoq për disa minuta, dha vendimin. Vetë mjekja Shpresa Karkanjozi deklaroi në sallën e gjyqit se ishte e pafajshme. Gjyqtari Agron Vavla lexoi dënimin për Karkanjozin, i cili u konvertua nga 1 vit burg në 2 vite shërbim prove. Gjyqtari Vavla vendosi gjithashtu edhe dënimin plotësues me heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit të mjekut për 2 vite. Nga ana tjetër, prindërit e vajzës u shprehën të pakënaqur me vendimin e dhënë nga Gjykata e Beratit, ndërsa deklaruan se do ta apelojnë atë.

Vendimi, KPK lë në fuqi shkarkimin e gjyqtarit Tom Ndreca, nuk justifikoi pasurinë

TIRANË - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka lënë në fuqi vendimin për shkarkimin e gjyqtarit Tom Ndreca. Ai u shkarkua nga detyra, pasi nuk justifikoi dot pasurinë e tij. Ndreca apeloj vendimin e KPK-së në kolegji, ndërsa trupi gjyqësor me relatore ish-kryeprokuroren Ina Rama, kryesuesse Albana Shtyllën dhe anëtarë Natasha Mulja, Rezarta Shultz dhe Sokol Çomo vendosën lënimin në fuqi të shkarkimit për ish-gjyqtarin e Gjykatës së Lartë. Gjyqtari Tom Ndreca ka qenë edhe pjesë e trupës gjyqësore, e cila shqyrtoi edhe dosjen e "21 janarit". Ai është një emër i njohur i drejtësisë për opinionin publik dhe mediat. Ndreca ka qenë relator i çështjes "Tahiri" për bilokimin e pasaportës. Po ashtu, ka qenë edhe gjykatësi që kryesoi në Kolegjin Zgjedhor çështjen e numërimit të votave në Tiranë, duke rrezuar kërkesën e Partisë Socialiste për shpalljen të pavlefshëm të vendimit të KQZ-së për numërimin e votave të hedhura në kutitë e gabuara. Një vendim që shpalli fitues në garën për Bashkinë e Tiranës, Lulzim Bashën.

Dorëheqja e Arben Isarait, emërohet drejtori i ri 'Patentave', Blendi Gonxhe

TIRANË - Blendi Gonxhe është emëruar drejtori i ri i 'Patentave' pas dorëheqjes së Arben Isarajit pak kohë më parë. Mësohet se Gonxhe ka qenë më herët Drejtori i Parqeve dhe Rekreationit në Bashkinë e Tiranës. Arben Isaraj dha dorëheqjen nga posti në datën 22 tetor pas arrestimit të vëllait të tij për trafik narkotikësh. Në letërën e dorëheqjes drejtuar ministrit për Energjinë dhe Infrastruktūrën, Isaraj kërkoi që të largohet nga detyra e tij për të mosndikuar në procesin gjyqësor të vëllait, Altin Isaraj. Ky i fundit u la në masën e sigurisë "Arrest me burg" nga gjykata, pasi akuzohej si pjesë e grupeve kriminale të trafikut të kokainës. Gjatë kontrollit, atij iu sekuestrua edhe një armë tip pistoletë, të cilën e posedonte pa leje.



ELBASAN

Tetë persona kanë përfunduar në pranga dhe një tjetër është shpallur në kërkim gjatë operacionit policor të koduar "Uraka 2", që u zhvillua dy ditë më parë dhe ku u sekuestrua një furgon me 578 kg kanabis. Një ditë pas bllokimit të automjetit në Pikën Kufitare të Qafë-Thanës, policia e Elbasanit ka dhënë detaje të reja në lidhje me operacionin antidrogë. Mësohet se ky operacion u finalizua pas marrjes së informacioneve në rrugë operative. Menjëherë u arrestua shoferi i furgonit, mjeti i cili i përket një firme fasonerie këpucësh me pronar Ilir Dauti. Bëhet fjalë për firmën "Silda shpk.", e themeluar në 30 nëntor të vitit 2001. Ndërkaq, ka reaguar pronari i kompanisë fasonerie, në emër të së cilës ishte regjistruar furgoni i kapur me drogë në Qafë-Thanë. Dauti deklaroi dje për "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" se furgonin e ka shitur, por akoma nuk është bërë noteria, pasi personi që e ka marrë nuk kishte paratë.

DRUGA DHE ARRESTIMET

Policia e Elbasanit dje deklaroi zyrtarisht se ka goditur një grup të strukturuar kriminal në fushën e trafikut të lëndëve narkotike. "Në kuadër të operacionit 'Forca e Ligjit në Territor', në vijim të kontrolleve të shumta të kryera në ambiente dhe automjete në akte rrugore, si dhe mbi bazën e informacioneve të marra në rrugë operative për një sasi lënde narkotike që po transportohej me një automjet furgon në drejtim të Korçës, nga specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve në DVP Elbasan në bashkëpunim me Forcën Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, më datë 21.11.2018, rreth orës 10:00 në fshatin Urakë, Njësi Administrative Rrajcë, Bashkia Prrenjas, në aksin rrugor Prrenjas-Pogradec është ndërhyrë dhe është bllokuar një automjet furgon 'Iveco', me drejtues mjeti shtetasin A.B.", thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë së Elbasanit. Ndërkohë, policia sqaroi nga kontrolli i ushtruar në brendësi të furgonit "Iveco" u gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale një sasi lënde narkotike prej 578 kg kanabis. Gjithashtu, u bllokuan edhe dy automjete të marra me qira nga këta shtetas në Fier, automjete të cilat shoqëronin furgonin me lëndë narkotike, konkretisht mjeti tip "Ford Focus" me drejtues shtetasin A. C., si dhe mjeti tip "Toyota Corolla" me drejtues mjeti E.H. Gjithashtu, u sekuestruan 14 aparate celularë dhe 5800 euro. Në përfundim të veprimeve të para hetimore u bë

Pronari i furgonit ku u gjet lëndë narkotike: E kam shitur, nuk kam lidhje

Sekuestrimi i 578 kg kanabis në Qafë-Thanë, arrestohen 8 persona dhe 1 shpallet në kërkim

Operacioni antidrogë i koduar "Uraka 2", policia: Goditëm një grup kriminal



Druga e sekuestruar në Qafë-Thanë



Ilir Dauti duke folur për "GSH"

PERSONAT E ARRESTUAR GJATË OPERACIONIT ANTIDROGË

1. E.M., 27 vjeç, banues në Fier.
2. A.C., (T.), 39 vjeç, banues në Fier.
3. A.B., 42 vjeç, banues në Levan, Fier.
4. E.H., 43 vjeç, banues në Elbasan.
5. G.R., 42 vjeç, banues në Elbasan.
6. E.Gj., 42 vjeç, banues në Pogradec.
7. A.Q., 24 vjeç, banues në Korçë.
8. L.D., 34 vjeç, banues në Tiranë.

NË KËRKIM

1. Shtetasi A.M., banues në Elbasan.

HETIMI

Sipas burimeve policore, mjeti me targë AA356NA që po transportonte më shumë se gjysmë tonelate drogë rezultoi të jetë në pronësi të një biznesi nga qarku i Fierit. Në operacionin antidrogë morën pjesë policia e Elbasanit si dhe forcat speciale, të cilat ndaluan furgonin me drogë jo shumë larg Pikës së kalimit kufitar me Maqedoninë, pasi e kishin mbajtur në vëzhgim të rreptë që nga vendi nga ku ishte nisur me ngarkesën e drogës. Operacioni u finalizua pas hetimeve disamujore nga antidroga se me këtë furgon trafikohet sasi e madhe droge me destinacion një nga vendet fqinje.

TË FURGONIT

Ilir Dauti deklaroi se nuk ka lidhje me ngjarjen ku u bë e mundur sekuestrimi i një sasive mbi gjysmë toni kanabis. "Personi që do blinte furgonin nuk i kishte paratë, ndaj nuk bëmë aktin notarial. Për shitjen e furgonit kemi bërë akt marrëveshje me personin. Likuidimin do ta bënte në fund të vitit, atëherë do bënim edhe kalimin e pronësisë", u shpreh Dauti. Ai pohoi se shoferi që drejtoi furgonin ishte vëllai i personit që e ka blerë. "Ky person nuk e dinte që vëllai ia kishte marrë furgonin. Nuk më erdhi mirë që u përmend emri im në këtë ngjarje. Furgoni i përket kompanisë sonë, por nuk ka asnjë lidhje me këtë ngjarje. Përmendja e emrit tim është në kundërshtim me ligjin, kanë abuzuar me mua", u shpreh pronari i fasonerisë. Dauti shtoi se furgoni kishte të shkruar edhe emrin e firmës tjetër që e kishte në përdorim. "Sot isha në polici dhe më thanë që nuk përfshihesh në hetim. Personi që ka në përdorim furgonin e pranon edhe sot që e ka blerë furgonin. Puna në kompaninë time vijon normalisht, pasi kjo s'ka asnjë lidhje", deklaroi pronari i fasonerisë.

Ish-kryeministri Sali Berisha: Ja kujt i përket droga e kapur në Qafë-Thanë

TIRANË - Ish-kryeministri Sali Berisha thotë se droga e kapur në Qafë-Thanë që sipas tij është 1 ton, është e partisë duke aluduar për kryetarin e Bashkisë së Elbasanit. Në një status në "Facebook", Berisha ka publikuar denoncimin e një qytetari dixhital, që thotë se dyshimet janë se droga i përket Lalës, ndaj dhe nuk ka deklaruar zyrtare nga policia. Deri tani policia nuk ka bërë të ditur zyrtarisht se sa ishte sasia e drogës së kapur në një furgon në

arrestimi në flagrancë i shtetasve: E.M., 27 vjeç, banues në Fier; A.C. (T.), 39 vjeç, banues në Fier; A.B., 42 vjeç, banues në Levan, Fier; E.H., 43 vjeç, banues në Elbasan; G.R., 42 vjeç, banues në Elbasan; E.Gj., 42 vjeç, banues në Pogradec; A.Q., 24 vjeç, banues në Korçë dhe L.D., 34 vjeç, banues në Tiranë. Nder-



Qafë-Thanë apo nëse ka persona të ndaluar.

STATUSI I BERISHËS

Breaking News:
Druga mbi 1 ton e kapur

sa është shpallur në kërkim shtetasi A.M., banues në Elbasan. Sipas hetuesve të çështjes, lëndë narkotike po transportohej në drejtim të Pogradecit dhe Korçës, ku do pritej nga shtetasit A.Q. dhe E.Gj. Për arsye hetimi, policia nuk bën me dije të dhëna të tjera. Ndërkohë që vijon puna për dokumen-

në Qafë-Thanë është e Partisë

Don Lala në tavë!

Lexoni mesazhin e qytetari dixhital, sb

Përsëritet Dr. Berisha!

Sipas një informacioni që më dha një oficer policie në Elbasan, më konfirmoi që droga në furgon ishte mbi një ton dhe dyshimet e para janë se u përket njerëzve të Lalës (Qazimit), prandaj edhe policia nuk po bën një deklaratë zyrtare! Gjithsesi, munda ta verifikoni për më gjerë këtë çështje!

timin e plotë ligjor të veprimtarisë kriminale të këtij grupi të strukturuar kriminal. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës për Krime dhe Rënda Tiranë për veprimet penale të "Trafikimit të narkotikëve". **REAGIMI I PRONARIT**

Mbante drogë të llojit ekzotik, përfunduar në pranga 29-vjeçari

VLORË - Një i ri nga Dhërmiu ka përfunduar në pranga, pasi është kapur me një sasi droge. Sipas policisë, i arrestuari është Klevis Bejko, 29 vjeç, banues në Dhërmi, të cilin pas kontrolleve iu gjetën dhe iu sekuestruan 19 tableta, të gjitha të mbushura me drogë që përdoren në fushën e ekzotizës. "Seksioni për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve ka bërë ndalimin e shtetasit Klevis Bejko, 29 vjeç, banues në Dhërmi, Vlorë. Ndali mi i tij u bë pasi Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.305, datë 21.11.2018, ka vendosur masën e sigurimit personal "Arrest me burg" për veprimet penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Më datë 05.08.2018, në Dhërmi nga kontrolli personal që shërbimet i kanë ushtruar këtij shtetasi, i kanë konstatuar 19 tableta të panjohura në atë kohë, por pas kryerjes së aktit të ekspertimit, kanë rezultuar se janë lëndë narkotike - droga të forta në fushën e familjes së ekzotizës", njoftoi policia.

PIJET ALKOOLIKE DHE ENERGJIKE NDRYSHIMET NË LIGJ

Kuvendi i Shqipërisë: Ndalohen pijet me gaz. Kontroll mjetit të identifikimit

Voltiza Duro

Tashmë pijet alkooolike dhe ato energjike nuk do të lejohen ligjërisht të konsumohen nga të miturit. Kuvendi i Republikë së Shqipërisë ka sjellë madje disa ndryshime në ligjin nr 9518 "Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkooolit" ku theksohet se përveç pijeve alkooolike do të ndalohet edhe përdorimi i pijeve energjike dhe atyre të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar.

MASAT DHE GOBAT

Në ligj bëhet me dije se ndalohet ofrimi i pijeve alkooolike dhe energjike të miturve nga personi madhor që e shoqëron atë në vende publike. "Ofrimi i pijeve alkooolike dhe pijeve energjike nga personat madhorë që shoqërojnë të miturit në njësi tregtare, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 mijë deri në 20 mijë lekë. Ofrimi i pijeve alkooolike dhe pijeve energjike nga personat madhorë që shoqërojnë të miturit në baret, restorantet, kinematë apo klubet e natës përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 20 mijë deri në 30 mijë lekë.", theksohet në ligj. Gjithashtu, në këtë të fundit bëhet me dije se shitja e alkooolit dhe pijeve energjike te personat nën 18 vjeç ndalohet rreptësisht nga të gjitha dyqanet, marketet apo njësitë e tjera të shitjes. Të gjithë personat e dyshuar si minorenë do të kontrollohen nëpërmjet mjetit të identifikimit për të ndaluar përdorimin e lëndëve të sipërpërmendura. Gjithashtu, do të ndalohet çdo lloj reklamimi i pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në institucionet arsimore për të mitur. "Ndalohet



Foto Ilustruese

transmetimi i publicitetit për pijet alkooolike, pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në brendësi të këtij programi drejtuar të miturve, si dhe 60 minuta para dhe pas këtij programi", thuhet në ligj. Ndërkohë, radiotelevizionet, mediat e shkruara publike ose private, si edhe agjencitë publicitare, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, duhet të miratojnë rregulla për përmbajtjen e mesazheve publicitare që kanë të bëjnë me pijet energjike dhe pijet e gazuara që

përmbajnë sheqer të shtuar.

SYNIMI

"Ky ligj ka si qëllim parandalimin e pasojave shëndetësore nga konsumi i alkooolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar nëpërmjet përdorimit të tyre nga të miturit", theksohet në ligj. Në këtë të fundit bëhet me dije se "pije energjike" konsiderohen ato pije joalkoolike, në të cilat përmbajtja totale e kafeinës tejkalon sasinë 150 mg/l dhe që në përbërje të tyre kanë të pakten një ose më shumë substan-

ca stimuluese ose tonike, të tilla si: taurinë, D-glukuronon y-lakton, guaranë, maltodekstrin, xhensen, karnitinë, kreatinë dhe ginkgo biloba. Ndërkohë, "pije të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar" konsiderohen ato pije joalkoolike, të gazuara, që përmbajnë sheqer, agjentë të tjerë ëmbësues apo aromatizues, natyral apo artificial, si dhe acid ushqimor, përjashtojë ujin mineral dhe ujërat e gazuara, lëngjet e frutave dhe pijet e bëra me qumësht ose produktet e qumështit.

ÇFARË NDALON LIGJI, MASAT ADMINISTRATIVE

- Ndalohet ofrimi i pijeve alkooolike dhe energjike të miturve nga personi madhor që e shoqëron atë në vende publike.
- Ofrimi i pijeve alkooolike dhe pijeve energjike nga personat madhorë që shoqërojnë të miturit në njësi tregtare, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10 mijë deri në 20 mijë lekë? -Ofrimi i pijeve alkooolike dhe pijeve energjike nga personat madhorë që shoqërojnë të miturit në baret, restorantet, kinematë apo klubet e natës përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 20 mijë deri në 30 mijë lekë
- Shitja e alkooolit dhe pijeve energjike te personat nën 18 vjeç ndalohet rreptësisht nga të gjitha dyqanet, marketet apo njësitë e tjera të shitjes.
- Të gjithë personat e dyshuar si minorenë do të kontrollohen nëpërmjet mjetit të identifikimit për të ndaluar përdorimin e lëndëve të sipërpërmendura.
- Do të ndalohet çdo lloj reklamimi i pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në institucionet arsimore për të mitur.
- Ndalohet transmetimi i publicitetit për pijet alkooolike, pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar në brendësi të këtij programi drejtuar të miturve, si dhe 60 minuta para dhe pas këtij programi
- Radiotelevizionet, mediat e shkruara publike ose private, si edhe agjencitë publicitare, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, duhet të miratojnë rregulla për përmbajtjen e mesazheve publicitare që kanë të bëjnë me pijet energjike dhe pijet e gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR SHOQUAR
ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje makine shkatërimi monedhash metalike për nevojat e Bankes se Shqiperise"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar shoqëruar me ftesa direkte kandidateve te huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 11,775,400 Lekë ose 93,300 Euro**."

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje makine shkatërimi monedhash metalike për nevojat e Bankes se Shqiperise"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **27 Dhjetor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



Novartis Pharma Services Inc. Tirana-Albania, the Representative Office of the multi-national company, NOVARTIS, the worldwide leader in the pharmaceutical industry, wants to hire a **Marketing Assistant**.

JOB PURPOSE:

Offers support for the marketing activities organised by the Representative Office in Tirana-Albania.

Some of his/her qualifications and requirements would be:

- University degree in Marketing, Business & Administration or other areas with similar knowledge
- Extra Knowledge of medical background preferable
- Very High Proficiency in English and local language (oral and written)
- Digital literacy with technology skills (Microsoft Office package)
- Outstanding organizational and coordination skills
- Excellent communications, interpersonal and negotiation skills
- Must demonstrate ability to prioritize and handle multiple tasks in a timely fashion, with minimum supervision and efficient follow-up
- Implement with excellence the planned activities and marketing campaigns adhering to the relevant Codes of Practice/regulations.

The interested candidates are invited to send the CV-s at the e-mail address: blerta.rambi@novartis.com. Deadline 30 November 2018

Only the selected candidates will be contacted.

Ish-zv.ministri Taulant Muka: Qeveria të reflektojë për kërkesat e të rinjve

Studentët, protestë para Kryeministrit: Ulni tarifën, kushte skandalozë

Lika: Shteti ka prioritetin kriminel dhe betonizimin, jo arsimin

Voltiza Duro

Ditën e djeshme studentët e universiteteve publike kanë protestuar për uljen e tarifave dhe rritjen e buxhetit për arsimin e lartë. Nën sloganin "Ulni tarifën, rritni buxhetin", ata nisën marshimin e tyre nga Universiteti Politeknik drejt Kryeministrit. Përkrah studentëve ka qenë edhe ish-zëvendësministri i Arsimit, Taulant Muka, i cili u dorëhoq disa ditë më parë nga posti. "Jam shumë i lumtur që studentët janë ngritur në protestë, që shprehin publikisht shqetësimet e tyre, (përbërë këtyri shteti 'WhatsApp'-i, që nuk u përgjigjet kërkesave të qytetarëve), ata reagojnë, ata publikisht denoncojnë. Zëri i çdo studenti duhet të dëgjohet në mbarë botën, të dëgjohet në çdo qeveri, të reflektohet në politikë dhe politikëbërja, e cila duhet t'i përgjigjet zërit studentor", - thotë Muka për "Gazeta Shqiptare". Ndërkohë, vetë studentët shprehën se profesorët shpeshherë iu shesin librat e tyre me detyrim. "Ne jemi pjesë e lëvizjes 'Për Universitetin' dhe kjo lëvizje ka disa vite që është themeluar dhe ka luftuar reformën e arsimit të lartë. Jemi këtu sepse tarifën e Bachelor-it, por edhe të masterit si profesional dhe shkencor janë shumë të larta për nivelin e pagave në Shqipëri dhe për kushtet në të cilat ne jetojmë. Kushtet në konvikte janë skandalozë, mësimdhënia ka shumë probleme, profesorët shesin libra në mënyrë të paligjshme, duke i detyruar shpesh studentët që t'i blejnë librat e tyre. Kështu që përveç faktit që duam të përgjysojmë tarifën, ne jemi këtu gjithashtu për të rritur buxhetin për arsimin publik. Kërkojmë edhe krijimin e një biblioteke, ku studentët të aksesojnë libra", - thekson Entenela Ndrevataj për "GSH". Gjithashtu, studentët tregojnë se iu duhet të punojnë për të mbijetuar e xhepi i tyre nuk i përballon tarifën e shkolimit. "Kam dalë të protestoj për padrejtësitë që po u bëhen studentëve në të gjithë Shqipërinë, ku shumica e shokëve e shoqeve të mia nuk kanë mundësi të ushqehen apo të jetojnë në Tiranë, e jo më të vijin e të paguajnë tarifën e shkollës që janë shumë të larta. Unë personalisht punoj në dy punë dhe e kam shumë të vështirë që në fund të semestrit të parë të jap 300 mijë lekëshin", - thotë studentja Jetmira Kasemi për "GSH". Studentët kanë kërkuar mes të tjerash edhe krijimin e një enti botues publik, që boton



Studentët dje gjatë protestës



libra universitarë me çmim të lirë. "Tarifat janë të papërbalueshme, e krahasuar me vendet fqinje janë shumë të larta. Ne urgjent kërkojmë përgjykim tarifash. Shteti

ynë kërkohet me rritje 0.1% të rritjes së buxhetit për arsimin. Kjo është e dhimbshme, nuk është se shteti shqiptar nuk ka para për të investuar për universitetet, por është çështje

prioritetesh. Mesa duket kanë prioritet betonin e kriminel. Vlen të theksojmë se kërkojmë edhe krijimin e një enti të një shteti botues publike, e cila të botojë libra universitarë me

çmime më të lira dhe të kontrolluara. Çdo ditë hasim në libra pa çmim, pa ISBN, pa kontroll e kjo duhet të ndryshojë", - thotë studenti Edisson Lika për "Gazeta Shqiptare". Pro-

testës së studentëve i janë bashkuar edhe shumë pedagogë, të cilët kanë kërkuar që qeveria të dëgjojë zërin e studentëve. "Dua të jetoj në një shoqëri më të mirë dhe të punoj në një universitet më të mirë. Për ta bërë këtë nevojitet rritja e subvencioneve shtetërore për arsimin publik, ulja e tarifave që do ta bënte arsimin të ndjekshëm sipas meritave dhe jo sipas xhepave. Kjo është një protestë masive, ndër shumë të tjera dhe ne mendojmë që i gjithë ky vit akademik që i jetë një vit rezistencash, një vit protestash, bllokimesh. Ne duam ta detyrojmë qeverinë që të na dëgjojë, boll ka dëgjuar vetëm ollgarkët, duhet të dëgjojë popullin, qytetarët, studentët e pedagogët", - thekson pedagogu Arlind Qorri për "GSH".

"Demokrati do të thotë të jesh i përgjegjshëm"

Shqiptari Fatos Malaj, kandidat për deputet në Greqi

Fatos Malaj, ndërmjetësi i ndërkulturor në Ministrinë e Emigracionit në Greqi, njëkohësisht kreu i organizatës "Arogi" për mbrojtjen e emigrantëve shqiptarë, bëri me dije se do të kandidojë për deputet në parlament grek. Pas viteve të shumta përkrahjeje për bashkëkombësit, Malaj ndërmerr një hap tjetër edhe më madhor: "Demokrati do të thotë të jesh i përgjegjshëm. Do të thotë të depërtosh brenda vetvetes dhe të peshosh veprimet. Veprimet e mia, jo të shtetit. Pikërisht ky detaj kërkon tepër kujdes: shteti sovran është gjithmonë individi. Kur referohemi tek shteti, në fakt flasim për përgjegjësinë personale, që në vijim ka peshë në jetën e të gjithë shoqërisë. Nëse ideja e demokracisë në epokën postmoderne është trazuar (si në nivel evropian, ash-



Fatos Malaj

tu edhe në nivel botëror), ndodhi sepse vlerat e mbrojtura tradicionalisht nga boshti human tashmë janë gërryer. Nuk ekziston më hierarkia transparente, jemi thjesht të humbur në konfuzion. Pa asnjë dyshim, po kalojmë fazën e riklasifikimit dhe ripërcaktimit të edukimit arsimor, të fesë, të shoqërisë, të familjes, të mar-

rëdhënieve, të martesës, të vetë qenies tonë", - thotë Malaj. Ky i fundit do të garojë për postin e deputetit krahas partisë së majtë "Lëvizje për Ndryshim". "Bota postmoderne e përcaktuar ekskluzivisht nga njeriu postmodern krijon një ide globale të demokracisë, mes një përpjekjeje trazimi të kulturave të shumta në një të vetme

europiane. Pika e dobët e perceptimit modern fshihet pikërisht tek ky fakt, se asgjë më nuk ka një profil të caktuar, esencë, që përkatës-vlerat tona janë përtjetërsuar dhe përzir në masë të tillë sa që as identifikohen më. Gjyhe e përleshjet, këndvështrime të njëjta, monedhë e njëjtë, negociata të njëjta, vota të njëjta etj. Përzjerja është vërtet praktikë, por edhe e rrezikshme sepse në këtë katrahurë kemi humbur përgjegjësinë personale. Këtu kërkohet mendje e kthjellët dhe e thjeshtëzuar. Çdo njeri hedh hapat e jetës bazuar në vërtetë që konsideron me vlerë", - thekson Malaj. Kreu i "Arogit" synon të jetë ai shqiptar që do të përfaqësojë më së miri emigrantët shqiptarë që jetojnë e punojnë në Greqi. "Demokracia është një ide, ose më saktë një sistem idesh. Kur ky sistem trazohet në

nivel të tillë sa që të deformohet, të humbasë vlerën, atëherë edhe vetë njeriu humbet besimin në këtë ide. Rezultati është nënvlefësimi i vlerave dhe virteteve që dikur themelolin hierarkitë, prodhonin kulturë. Përgjithësisht, bota europiane zgjerohet dhe rrit fëmijë (ne, domethënë) të cilët duan të jenë të lirë, të kenë të drejtë të barabarta, të bashkëjetojnë në demokraci, të përfaqësohen nga individë të fuqishëm dhe paralelisht të kenë zero përgjegjësi personale përkundrejt çdo katastrofe apo tragjedie. Europa në këtë moment funksionon si një organizatë e mbyllur, e fortifikuar nga një ekonomi e fuqishme. Nëse je pjesë e saj, je në rregull, nëse je jashtë, mëso të notosh! Ndoshka ky është edhe përcaktimi më i saktë e modern i Demokracisë Europiane", - thotë Malaj./vo.du.

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me përmbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 11.12.2018 ora 8:00 - 16:00 në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II-të për shitjen e pasurisë të paluajtshme, Apartament me Nr.pasurie.6/143+1-38 me adresë "Lagja 16 Prilli", me sipërfaqe totale 120 m², Zona Kadastrale Nr.8534, Vol.8, Fq.161. Fier në pronësi të z.Mihal Jorgo Gjukurit me vlerë fillestare në ankand 30.240 (Tridhjet mijë e dyqind e dyzet) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me përmbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 14.12.2018 ora 8:00 - 16:00 në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I-re për shitjen e pasurisë të paluajtshme, Arë me sipërfaqe 1500 m², nr. 179/87, vol. 8, fq. 19 zk. 2326, në Kuman, Fier në pronësi të Z. Arben Refat Ramizi me vlerë fillestare në ankand 600.000 (Gjashtëqind mijë) Lekë. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

SHPALLJE ANKANDI
Zyra Permbarrimore "E.G Bailiff Service" me përmbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 14.12.2018 ora 8:00 - 16:00 në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i I-re për shitjen e pasurisë të paluajtshme. Trulli me sipërfaqe 1000 m² ndodhur në ZK. 2399, Nr. 281/20, Vol. 13, fq. 9 nga kjo Ndërtesë me sipërfaqe 134 m² në pronësi të Z.Illir Alush Uku me vlerë fillestare në ankand 8.000.000 (Tetë milion) lekë. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

BOTIMI

Sot del në qarkullim libri më i fundit i "Mjeshtërit të madh" Bashkim Zeneli, "Miqësi e trazuar"

Si elektrizoi zëri i Inva Mulës diplomatë, politikanë dhe artistë e qytetarët në Athinë

(vijon nga nr. i djeshëm)

Sot del në qarkullim libri më i fundit i Bashkim Zeneli, dekoruar me titullin "Mjeshtërit të madh", "Miqësi e trazuar". Greqia në kujtimet e ambasadorit, nga UET press. Një libër që veç historisë së marrëdhënieve mes dy vendeve, ndërthuret bukur me histori të antikitetit duke u bërë më interesant për lexuesin shqiptar. "Gazeta Shqiptare" po boton një pjesë të librit, i cili nga sot do të jetë në dorë të lexuesit.

Bashkim Zeneli

Në Athinë do të themelohej Akademia nga Platoni (427-347 p. K.) që ishte bashkëkohës dhe mik i Perikliut. Aty, midis të tjerash, do të niste edhe një koncept i ri për botën e për kuptimin e saj. Platoni vinte nga radhët e aristokracisë dhe ishte i angazhuar në veprimtari politike. Por, pas vdekjes së mësuesit të tij, Sokratit, iku 12 vjet larg Greqisë dhe iu kushtua kërkimeve për dëjnitë politike.

Në Akademinë që themeloi Platoni do të studioje për 20 vite radhazi Aristoteli (384-322), megjithëse thuhet se nuk arriti kurrë të bëhet pasardhës i denjë i tij. Thuhet se i pyetur se çfarë i kishte mësuar Aleksandërit të Madh që në fillim, ai i ishte përgjigjur se i kishte mësuar që asnjëherë fjalitë nuk duhet të fillojnë me unë...

Por ai do të bëhej i famshëm si mësuesi dhe edukatori i përkushtuar i Aleksandërit të Madh. Në vitin 332 p. K. do të themelonte në Athinë "Lykeion" - Liceun.

Mësuesi i Platonit, Eudoxos, nga Kridos, mbi bazën e vëzhgimeve astronomike, vendosi tokën në qendër të sistemit të 27 sferave qiellore. Dhe këto punime të jashtëzakonshme të kohës, do të pasuroheshin më tej nga Aristoteli... (384-322)

Vetë Platoni do të zhvillonte edhe kryeveprën e tij "Politeia" - Shteti.

Do të merrnin në atë kohë një zhvillim të madh filozofia dhe historia, që kishin nisur mbarë që në vitet 600 p. K., por tanimë, ato ulidhën ngushtësisht me shkencat e natyrës. Dhe sa larg kësaj ishte "pjesa" tjetër e botës. Nderim për ata burra të shquar athinas, por jo vetëm!...

Filozofët e mëdhenj

Salla e gurtë e Herodionit do të oshinte. Mbi 5000 spektatorë veç duartrokisnin pa pushim

ishin edhe shkencëtarë të natyrës dhe i përkisnin filozofisë joniane... me Thales, Anaximenes, Anaximandros etj. Ata nisën të bëjnë punime me vlerë në fushën e kërkimeve, sidomos për gjeografinë, astronominë, matematikën.

Pitagora, i pari që do të shihte botën si zar, të rrumbullakët, si kozmos, që funksionon në bazë të disa ligjësive. Prej Pitagorës edhe sot përdoret termi Harmoni, si rend i rregullave. Do të ishte Pitagora që do të zbulonte ndërtimin matematik të harmonisë muzikore duke arritur edhe deri në përcaktimin se kozmosi (bota) ka një strukturë të caktuar matematikore.

Sokrati (469-399) do të ngrihej kundër sofistëve dhe spekulimeve të tyre duke iu përgjigjur me shprehjen, edhe sot të famshme, për masën e gjërave, se "unë di atë që nuk di". Sokrati ka qenë shumë kritik me problemet e edukimit të fëmijëve dhe rinisë. Ai do të shprehte se "edukimi i fëmijëve është një profesion ku duhet të kuptosh kohën që humb, pikërisht për të fituar kohë". Ose: Fëmijët që nuk i do, do të bëhen të rritur që nuk do të dinë të duan.

Për Thales treguesi i ndërtimit të botës ishte uji, ndërsa për nxënësin e tij, Anaximenes, ishte ajri. Herakliu shihte zjarrin si element të lëvizjes dhe të zhvillimit. Më 450 p. K., Peokippus dhe nxënësi i tij, Demokrites, flasin për herë të parë për trupat në natyrë që ndryshojnë dhe kanë për bazë atomin.


Por pika kulmore e shkencës dhe kërkimit "kalon në vitin 302 p. K. drejt Aleksandrisë, ku Ptolemeu i parë ndërtoi një muzeum të madh dhe më pas

një bibliotekë me disa qindra mijëra libra".

... U shkëputa jo pak nga mbrëmja e famshme e Inva Mulës dhe tenorit të spikatur e simpatik grek Marios Fragulis, në Teatrin e madh antik Herodion të Athinës, jo pa një qëllim: fola, shumë përmbledhtas, për Athinën antike, për zhvillimin e saj të mahnitshëm, për udhëheqësin e saj legjendar Perikliun, që do të kujdesej aq shumë e do ta rriste madhësinë e teatrit Herodion, si askush tjetër.

Dhe në këtë atmosferë, edhe antike, dukej se jehona e 2500 viteve më parë, do të vinte natyrisht, pa u kuptuar, por duke u nderuar në atë mbrëmje të madhe festive të 1 tetorit 2003. Do ta lidh këtë me një thënë të madhe të Pablo Picasso: "Arti i Greqisë, i Egjiptit dhe i artistëve të mëdhenj që jetuan në antikitet, nuk është arti i së shkurës. Ai është shumë më jetësor sot se kurrë më parë, se asnjëherë".

Athina, aty ku lindi dhe u ndër-



BASHKIM ZENELI

UETPRESS

MIQËSI E TRAZUAR

Greqia në kujtimet e ambasadorit

Me parathënie nga Henri Çili

tua teatri i madh 5000 vendesh, do ta priste atë koncert, të cilit i ishte bërë një jehonë shumë e madhe. Dhe ne shqiptarët ndiheshim krenarë.

Një teatër, kryesisht i gurtë, me histori si vetë qyteti, si Athina, si Greqia. Nëse ulesh në shkallët e tij dhe sheh Akropolin, apo më të poshtë, lagjen ndër më të bukurat e më të vjetrat në botë, lagjen Plaka, nuk mund të mos meditosh për atë të kaluar të madhe, të ndritur, të respektueshme të popullit grek. Ajo i përket në radhë të parë atij, por i përket tashmë edhe të gjithëve, i përket mbarë botës, që Greqia e famshme i dha aq shumë, i dha pafundësisht. Dhe ndaj shkrova më sipër për ato vite...

Do të ndienim të gjithë kënaqësi që rrugët e Athinës ishin të mbushura me postera të Invës dhe të Marios për koncer-

tin që do të jepnin. Me shumë vesh-tirësi arritëm, si ambasadë, të siguronim bileta për bashkatdhetarët, për artistë, muzikantë, poetë, shkrimtarë, piktorë e figura të tjera të shquara nga radhët e emigrantëve shqiptarë. Dhe do të ishte vërtet një nder i madh për ne, që me biletat që u dërguam, do të kishte një prani aq të madhe të ambasadorëve dhe diplomatëve të vendeve të ndryshme. Disa nga ambasadorët që ishin jo rezidentë edhe në Shqipëri, do të vinin me buqetë me lule. Me shumë nga ambasadorët, miqësisht, fola vetë në telefon: Është një artistë e madhe, ndër më të njohurat në botë, është një nder i madh për ne... unë ju pres në Akropol, në Herodion...


Dhe ata përgjigjeshin: "Do të vij, koleg, do të vij patjetër!"

Personalitete greke të politikës, artit, kulturës, shkencës, muzikës etj., do të uleshin në shkallët e teatrit.

Një prani e dukshme edhe e bashkatdhetarëve që kishin mundur të siguronin vetë bileta. Telefonat me kërkesa nuk pushonin në ambasadë... Por edhe telefona të gazetarëve për të intervistuar Inva Mulën.

Për ne shqiptarët në Athinë ishte një ditë e bukur, e mrekulueshme dhe e paharruar. Ishte "dita jonë, mbrëmja jonë". Dhe e çmonim shumë! E çmonim se nuk kishim shumë ditë të tilla, ditë që na duheshin përherë, ditë që na rrisnin, na krenonin!

Së bashku me Engjëllushen, por edhe me diplo- ➔



Bashkim Zeneli

matë të ambasadës, do të ishim bashkë, gjatë një kohe të gjatë me Invën. Do të shënisim nëpër Athinë, do të shihnim vende historike dhe muze, do të uleshim në Kolonaki për kafe dhe në Vullagmeni për një drekë apo darkë së bashku.

Inva do të niste "koncertin" e saj me intervistat dhe deklaratat për shtypin grek, por edhe për atë shqiptar të Athinës.

Foli për artin, për kulturën, për muzikën që i bashkon popujt; foli për historinë e shquar të Greqisë, që nga antikiteti, foli për kompozitorë të mëdhenj grekë e këngëtarë të famshëm, foli për muzikantë të njohur në Europë, emigrantë shqiptarë që ishin të spikatur në orkestrat më të njohura greke. Foli për mirënjohjen ndaj popullit grek që kishte pritur bujarisht qindra mijëra shqiptarë, foli për vetë emigrantët shqiptarë që përfaqësonin vlera të njohura të popullit tonë në fusha nga më të ndryshmet. Foli shumë mirë, shumë qartë, shumë hapur. Ishte, pa kuptuar, një sfidante e vërtetë, për ato që tha, edhe për shumë e shumë politikanë shqiptarë, me paragjykimet e me mosbesim se dy vendet tona mund të shkojnë mirë e duhet të shkojnë mirë.

Dhe fjala e saj kishte peshë të veçantë sepse "përzihet" mjeshtrja e madhe me një "politikanë" të zgjuar, të qartë e me mesazhe paqësore.

Por shumë bukur do të fliste edhe artistin i madh grek Marios Frangulis kur intervistoi të bashku me Invën.

Nuk do të ndalesha aq shumë në intervistat e mrekullueshme të Inva Mulës "jashtë skene" në Greqi, nëse në këto momente që po shkruaj nuk do të kujtoja një tjetër intervistë të mrekullueshme, virtuozet, të Invës në Beograd, ku ajo ishte për koncert dhe ku ishte pritur edhe shumë miqësisht e me nderim nga kryeministri (sot president) i Serbisë, z. Aleksandër Vuçiq. Një pamje televizive që fliste vërtet shumë. Ishte një intervistë që Inva Mula i dha gazetarit të spikatur e plot finesë të TCH në Beograd, Idro Seferi. Inva tha çdo gjë natyrshëm, ashtu si e mendonte, ashtu si duhej. Ajo nuk do të dihte të fliste ndryshe.

Foli shumë bukur për artin dhe kulturën, foli shumë bukur për marrëdhëniet midis të dy popujve dhe të dy vendeve, për domosdoshmërinë për të shkuar mirë bashkë, për të ardhmen e përbashkët europiane që na pret. Vërtet se kush e ka ndjekur atë intervistë, do të thotë se ishte një mesazh

shumë: Faleminderit se e bërë mrekullisht detyrën tënde si një misionare për Europën, për paqen, për lirinë, për mirëkuptimin, për bashkëpunimin midis popujve dhe vendeve! Një artiste e madhe, një shqiptare e madhe, një europianiste e madhe!

...Teatri i gurtë i Athinës, në atë mbrëmje të bukur, ishte i mbushur plot. Kishin ardhur artistë të njohur grekë dhe shqiptarë, personalitete, politikanë, ministra, deputetë, diplomatë.

Inva doli në skenë bashkë me Mario Frangulis. Teatri ishte në këmbë. Mbi 5000 spektatorë veç duartrokisnin pa pushim, që shprehnin veç respekt dhe dashuri. Të gjithë prisnin triumfin, suksesin. Ne, natyrshëm, na kishin pushtuar emocione të fuqishme. E shihnim veten shumë mirë në këtë atmosferë dhe na dukej se "të gjithë" na shihnin edhe neve, në këmbë, duke duartrokitur; edhe mua, edhe Engjëllushen, edhe Ermelinda Meksini e ndëruar, me të gjithë bashkatdhetarët.

Inva ishte veshur me një fustan



të gjatë, të kuq dhe kishte lidhur edhe një shall të lehtë po të kuq. Prezantuesja e koncertit i bëri Invës një "biografi" artistike të mrekullueshme, një paraqitje dinjitoze, si sopranoja që prej vitesh

mënyrë të shkëlqyer e do të kthehej e rikthehej në duartrokitjet e fuqishme të publikut.

Do të këndonte bashkë me Mario Frangulis dhe përsëri nuk do të pushonin duartrokitjet. Salla e gurtë e Herodionit të Athinës do të oshinte. Publiku mbeste shpesh

INVA MULA

"Disa nga ambasadorët që ishin jo rezidentë edhe në Shqipëri, do të vinin me buqetë me lule. Me shumë nga ambasadorët, miqësisht, fola vetë në telefon: 'Është një artiste e madhe, ndër më të njohurat në botë, është një nder i madh për ne... unë ju pres në Akropol, në Herodion... Dhe ata përgjigjeshin: 'Do të vij, koleg, do të vij patjetër!'".

në këmbë për minuta të tëra.

Një sukses i jashtëzakonshëm, nën Akropol, pranë Propylaia, tempullit të perëndeshës së Athinës. Ai teatër, ndër sukseset e këngëtarëve dhe artistëve me famë botërore, do të regjistronte në

Mulës, Mario Frangulis dhe pianistit të njohur spanjoll Edelmiro Arnaltes. U dhuruar lule edhe soprano të njohura Kerin Inghland dhe Rebeka Najt (Knight)...

Ndenjem gjatë në skenë, së bashku me personalitetet greke të artit dhe kulturës, pranë një pub-

liku që nuk pushonte duartrokitjet.

Në skenë ishin ngjitur edhe shumë fotografë e reporterë televizivësh. Gazetarët donin me çdo kusht të intervistonin Invën dhe Marion...

Ishte një shfaqje jo thjesht e madhështisë së Inva Mulës, por edhe e mirëkuptimit, e miqësisë midis dy popujve tanë, e respektit për njëri-tjetrin, për vlerat e mëdha të kulturës dhe artit në të dy anët e kufirit. Muzika, kënga, arti, kultura, letërsia, sporti kanë një forcë të madhe për të bashkuar e miqësuar njerëzit. Dhe kjo ishte, pa dyshim, gjëja më e bukur e këtij koncerti. Dukej se pa kuptuar, pa firmë e pa vulë, pa protokoll e pa bujë, kishim nënshkruar një marrëveshje të fortë mirëkuptimi!...

Nuk ishte aspak pa domethënie që, të nesërmen, në faqet e para të gazetave kryesore, Inva Mula dhe

se teatri i rrallë antik u ngrit disa herë në këmbë duke duartrokitur. Avni Mula nuk fliste dot, u mallëngye së tepërmi (dhe Inva do të na thoshte se kështu i ndodh përherë... është tepër i ndjeshëm).

Ai vetë kishte ngritur në këmbë publikun e skenave më të njohura të Europës. Ai talent i jashtëzakonshëm, që student, në Moskë, do të kishte privilegjin dhe nderin të këndonte në 'Balshoj' Teatër. Një familje e madhe artistësh të shquar, të kulturuar, plot mirësi e hijeshi. Një familje zemërmadhe e fisnike, bashkë me virtuozet e spikatur e të paharruar, rusen e mrekullueshme Nina Mula.

Intervistat do të vazhdonin në shtypin grek. Artistët të njohur shqiptarë do të vinin ta takonin...

Inva shkëlqen në gjithçka. Athina jetoi 2-3 ditë me të! Bëri shumë nder Shqipërisë në Greqi.

E përçolla në aeroport për në Tiranë, por jehona e koncertit të saj do të vazhdohte në Athinë. 'Tashmë jo më në shtyp e në mjediset artistësh, por do të vazhdohte edhe në politikë...

Zv/kryeministria Ermelinda Meksi do të pritej nga ministri i Jashtëm, z. Papandreu. Dhe në fillim u fol për suksesin e Inva Mulës, u fol se sa shumë i shërbeu forcimit të marrëdhënieve midis të dy popujve, arti, kultura, letërsia...

Zoti Papandreu do të theksonte se "marrëdhëniet midis të dy vendeve sot janë në nivelin e tyre më të lartë. Viti që po mbylлим, ishte një vit model i bashkëpunimit. Është shumë e rëndësishme që grekët dhe shqiptarët sot janë më të afatuar se kurrë me njëri-tjetrin. Kjo është një garanci shumë e madhe për të ardhmen. Shqiptarët në

KONCERTI

Muzika, kënga, arti, kultura, letërsia, sporti kanë një forcë të madhe për të bashkuar e miqësuar njerëzit. Dhe kjo ishte, pa dyshim, gjëja më e bukur e këtij koncerti. Dukej se pa kuptuar, pa firmë e pa vulë, pa protokoll e pa bujë, kishim nënshkruar një marrëveshje të fortë mirëkuptimi!...

Mario Frangulis ishin të fotografuar në skenë plot solemnitet, dorë për dorë e me buqetë të mëdha lulesh.

Duke dalë, do të më uronin shumë ambasadorë, politikanë grekë, ministra, artistë, me një fjalë të vetme: E mrekullueshme!

(Të nesërmen, kur me Invën dhe Engjëllushen shkua në "Grand Bretagne" për të pirë një kafe, do të na afrohej menjëherë mikun im, drejtori i hotelit Tem Ananiadis dhe do të na përshëndeste shumë miqësisht: "Të faleminderit zoti ambasador që e sollët këtë artistë të madhe këtu. Na nderon. Ju kemi ndjekur në televizor... na keni surprizuar! - do t'i drejtohej Invës... Ju faleminderit shumë! I keni dhënë shumë vendit tuaj me atë koncert madhështor!...")

Nga "Grand Bretagne" do t'i telefonojta babait të Invës, mjeshtrit të madh dhe "Artistit të Popullit", nderit të kombit, këngëtarit të famshëm Avni Mula. Jam njohur prej shume vitesh më parë me artistin. E përshëndeta miqësisht dhe i fola për suksesin e jashtëzakonshëm të Invës. E thashë me gjithë zemër sa na rriti jashtë mase imazhin tonë, emrin e Shqipërisë,

Athinë, por edhe në qytete të tjera, po kontribuojnë shumë në përfundimin në kohë të objekteve olimpike. Në do të vazhdojmë të mbështesim Shqipërinë në rrugën e saj të integritimit në BE. Është një rrugë e gjatë dhe me sakrificë, por integritimi në BE është e vetmja rrugë që të çon drejt suksesit ekonomik, social dhe politik. Ne do të bëjmë prezent kërkesat tuaja dhe do të kërkojmë nga Komisioni Europian gjetjen e mekanizmeve sa më të përshëndetshme për mbështetje financiare dhe në programe komunitare zhvillim, sidomos në fushën e infrastrukturës. Ne mbylлим me sukses të plotë Samitin e Selanikut duke hapur një perspektivë të qartë për proceset integruese euroatlantike të vendeve të Rajonit. Dhe pa asnjë dyshim, këtu Shqipëria zë një vend të veçantë."

Zonja Meksi do të pritej edhe nga ministri plotësues i Punëve të Jashtme, i ngarkuar me çështjet europiane, z. Janicis, dhe nga kryetarja e Bashkisë së Athinës, zj. Bakojanis.

Një takim që zonja Meksi zhvilloi në ambasadë me drejtues të shoqatave shqiptare, do të ishte shumë frytdhënës.

ARISTOTELE

Në Akademinë që themeloi Platoni do të studioje për 20 vite radhazi Aristoteli (384-322), megjithëse thuhet se nuk arriti kurrë të bëhet pasardhës i denjë i tij. Thuhet se i pyetur se çfarë i kishte mësuar Aleksandërit të Madh që në fillim, ai i ishte përgjigjur se i kishte mësuar që asnjëherë fjalitë nuk duhet të fillojnë me unë ...

shumë i qartë për të parë përpara, për të lënë pas të kaluarën e mbushur me armiqtë, mërija dhe konfliktet.

Dhe Invës i duhet thënë pafundësisht: Faleminderit! Faleminderit se na bërë krenarë kur ngrite "sallën" në këmbë, por më

kishte pushtuar skenat më të njohura të botës, që nga 'La Scala' e Milanos deri te ... 'Metropolitan Opera' në SHBA, që nga Parisi e Tokio, Berlini e Vjena, Londa e Brukseli etj., etj.

Do të dilte në skenën e teatrit antik duke interpretuar në

"arkivin" e tij antik e të ri edhe jehonën e interpretimit të Inva Mulës. Dhe nëpër prospektet, libra dhe albume, kur të flitet se kush ka kënduar në Herodionin e Athinës, pa frikë do të shënohet edhe një shqiptare e madhe, me famë botërore: Inva Mula. Do të jetë në radhë me më të mëdhenjtë e botës, me Sinastrën, Cabaille, Irene Papas, me Marinelën, me Carreras, Domingo, Pavarotti etj., etj.

Duket se me suksesin e Invës kishte jetuar atë mbrëmje jo vetëm lagjja "Plaka", më e vjetra e Athinës, por, pranë saj, edhe Roma Agora, e ndërtaur si dhuratë e Julius Caesar dhe Augustus... Mjeshtri i madh grek Hyppodamos që kishte ndërtuar këtë qytet model të lashtësisë, do të ishte me siguri shumë krenar për Odeonin Irodu Atiku që vazhdohte të shpërndante jehonë...

Së bashku me Engjëllushen dhe zonjën Meksi u ngjitem në skenë, ndërsa publiku ishte i tëri në këmbë, me duartrokitjet të pandërprera. U dhuruar buqeta me lule Inva

TAKSA E KOSOVES NDAJ SERBISE REAGIMET

Moslejimi i kamionëve, autobllinda të policisë kosovare në Mitrovicën Jugore

Kosova bllokoi mallrat serbe, tensione në kufi

Taksa për Serbinë, Haradinaj i prerë në vendim

Masa ndaj importit të mallrave serbe nuk duhet të hiqet derisa Serbia ta njohë pavarësinë e Kosovës, këto janë fjalët e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj. Ndërkaq vendimi i qeverisë kosovare hyri në fuqi menjëherë. Siç duket edhe në pamjet e publikuara në mediat kosovare, asnjë kamion me mallra nuk hyri nga Serbia. Ndërsa disa autobllinda të policisë së Kosovës u shfaqën në Mitrovicën Jugore, për të qenë të përgatitur për çdo tensionim të situatës. Deklaratat Haradinaj i bëri gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës, ku po diskutohet për politikën e Jashtme të vendit. "Unë mendoj se masat që kemi vendosur ndaj prodhimeve që vijnë nga Serbia duhet të jenë të përhershme deri në njohje, derisa Serbia nuk e njeh Kosovën shtet të pavarur dhe sovran nuk duhet ta heqim" tha Haradinaj. Ai më tej bëri thirrje të mos ketë tërheqje ndaj këtij vendimi edhe përkundër faktit se mund të ketë siç tha "lutje, përkrahje apo këshilla si kundërvlerë për këto masa". Pasi doli nga seanca e Kuvendit, Haradinaj u tha gazetarëve se u ka shkruar letër ambasadorëve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe Përfaqësueses së BE-së, Nataliya Apostolova, përmes së cilës i ka njoftuar me arsyet e vendosjes së takses. Nga ana tjetër, deklarata e kryeministrit Haradinaj bëhet një ditë pasi qeveria e Kosovës vendosi të rrisë taksen doganore ndaj prodhimeve të Serbisë dhe Bosnjës nga 10 përqind sa ishte deri tani, në 100 përqind. Bashkimi Evropian ka bërë thirrje që kjo taksë të hiqet menjëherë pasi përbën shkelje të marrëveshjes së tregtisë së lirë, e njohur si CEFTA. Ndërkohë që pasi autoritetet e Kosovës ashpërsuan masat kundër mallrave të Serbisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, në Beograd mendohet se këto masa do të dëmtojnë më shumë Kosovën se ekonominë e Serbisë. Vendimi i qeverisë së Kosovës për ngritjen e taksave ndaj mallrave serbe në 100% është komentuar në Beograd si një



Kryeministri i Kosovës,
Ramush Haradinaj



ALEKSANDAR VUČIĆ

"Serbia është tepër e shqetësuar për pozitën e serbëve në Kosovë si dhe për sigurinë në rajon. Këto masa e bllokojnë praktikisht tregtinë mes Serbisë dhe Kosovës. Prishtina ka për qëllim të dëbojë serbët dhe të detyrojë Beogradin të kapitulojë. Ju lus sikur Zotin, që të tërhiqni këto masa. Të gjithë kemi nevojë për paqe", - tha presidenti serb, Vučić.



RAMUSH HARADINAJ

"Unë mendoj se masat që kemi vendosur ndaj prodhimeve që vijnë nga Serbia duhet të jenë të përhershme deri në njohje, derisa Serbia nuk e njeh Kosovën shtet të pavarur dhe sovran nuk duhet ta heqim. Të mos ketë tërheqje ndaj këtij vendimi edhe përkundër faktit se mund të ketë lutje, përkrahje apo këshilla si kundërvlerë për këto masa", - tha Haradinaj.



FATMIR LIMAJ
Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka paralajmëruar Serbinë se Kosova mund ta marrë edhe një masë tjetër ndaj saj, pas vënies së taksës prej 100 për qind ndaj mallrave serbe. "Qeveria e Kosovës është duke shqyrtuar aplikimin e reciprocitetit me Serbinë për targa të automjeteve. Reciprociteti do të detyronte automjetet me targa të Serbisë që t'i ndërronin ato me targa të përkoreshme, para se të hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës", - ka thënë Limaj.



Kufiri

BLLOKIM NË DOGANË

Siç duket edhe në këto pamje të publikuara në mediat kosovare, asnjë kamion me mallra nuk hyri nga Serbia. Ndërsa disa autobllinda të Policisë së Kosovës u shfaqën në Mitrovicën e Jugore, për të qenë të përgatitur për çdo tensionim të situatës.



BBC

"Reuters" thotë se nga vendimi i qeverisë u kërkua gjithashtu të ndalohej hyrja e ndonjë malli që nuk e ka adresuar Kosovën me emrin e saj kushtetues, Republika e Kosovës, të cilën Serbia dhe Bosnja nuk e njohin. "Kosova fajësoi Serbinë për dështimin e saj për t'u bashkuar me INTERPOL-in dhe tha se Serbia ishte kundër normalizimit të marrëdhënieve, një çelës për të dyja vendet. Bosnja votoi gjithashtu kundër anëtarësimit të Kosovës", - shkruan "Reuters".

kundërpërgjigje ndaj dështimit për anëtarësim në Interpol dhe një hakmarrje për këtë dështim diplomatik. Beogradi e sheh këtë hap si një masë politike që nuk ka lidhje me ekonominë. Ndaj ka kërkuar reagime shumë të ashpra të Bashkimit Evropian dhe Uashingtonit. Serbia eksportoi mallra në Kosovë në vlerë prej rreth 440 milionë euro, ndërsa importon mallra në vlerë prej rreth 21 milionë në vit. Ky ekuilibrim po zgjat me vite të tëra, ndaj shtrohet pyetja pse ky vendim në këtë moment, kur dihet se me ngritjen e taksave do të ngrihen edhe çmimet e mallrave në Kosovë dhe mund të bie standardi i jetës? Në Serbi thuhet se këto masa janë një rast precedent në ekonomi dhe nuk kanë logjikë ekonomike. Nga ana tjetër Shqipëria dhe Serbia po punojnë për lehtësimin e procedurave doganore mes dy vendeve. Ministri i Financave Arben Ahmetaj ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Beograd, ku u takua me homologun e tij Sinisa Mali. Ahmetaj ka kërkuar eliminim të barrierave doganore dhe reduktim të dokumenteve për mallrat që lëvizin transit. Ai ka kërkuar po ashtu bashkëpunim politik dhe ekonomik të dy vendeve, pasi kështu fitojnë të dy shtetet.



Komisionieri për Zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn ka përsëritur deklaratën e Përfaqësueses së Lartë të BE-së, Federica Mogherini, se taksa e Kosovës ndaj mallrave të importuara prej Serbisë është shkelje e CEFTA-s. Sipas Hahnit, kjo taksë shkel parimet e tregtisë së lirë. "Ky akt që po ashtu dëmton konsumatorët dhe bizneset kosovare duhet të kthehet prapa menjëherë. Kosova mban kryesimin e CEFTA-s dhe për këtë ka përgjegjësi të veçantë. Do të marr pjesë në javën e CEFTA-s në Prishtinë së shpejti dhe pres që kjo të zgjidhet deri atëherë", - ka shkruar Hahn në "Twitter".

Hahn kundër taksës së vendosur ndaj mallrave serbe

Komisionieri për Zgjerim i BE: Ky akt dëmton edhe konsumatorët e bizneset kosovare



Johannes Hahn

"Ky akt që po ashtu dëmton konsumatorët dhe bizneset kosovare duhet të kthehet prapa menjëherë. Kosova mban kryesimin e CEFTA-s dhe për këtë ka përgjegjësi të veçantë. Do të marr pjesë në javën e CEFTA-s në Prishtinë së shpejti dhe pres që kjo të zgjidhet deri atëherë", - ka shkruar Hahn në "Twitter".

Federica Mogherini

"Vendimi i Prishtinës për ngritjen e tarifave për produktet nga Serbia dhe Bosnje-Hercegovina në mënyrë të qartë shkel marrëveshjen CEFTA dhe MSA-në", deklaroi shefja e diplomacisë europiane, Federica Mogherini.

këto vendime", thuhet në njoftimin për media të BE-së. Shefja e diplomacisë europiane, Federica Mogherini ka dënuar vendimin e Prishtinës për të rritur tarifën dhe ka kërkuar që vendimi i saj të tërhiqet. "Vendimi i Prishtinës për ngritjen e tarifave për produktet nga Serbia dhe Bosnje-Hercegovina në mënyrë të qartë shkel marrëveshjen CEFTA dhe MSA-në", deklaroi Mogherini. Ajo i kërkoi qeverisë së Kosovës që menjëherë të shfuqizojë masën. Më parë, në Komisionin Europian thanë se përgjigja e BE-së ndaj vendimit të qeverisë së Kosovës pritet sa më shpejt që të jetë e mundur.

100 për qind për produktet serbe dhe boshnjake. "Më tej përkeqëson situatën pas imponimit fillestar të taksës prej 10% të rritjes së taksës javën e kaluar. Qeveria e Kosovës duhet të revokojë menjëherë

Vendimi i Prishtinës, produktet shqiptare në vend të atyre serbe në Kosovë

Pamela Aliaj

Pas vendimit për tak sën 100% ndaj mallrave serbe dhe boshnjake në Kosovë duket se bizneset shqiptare e shohin si një derë të hapur rrugën drejt tregut të Kosovës. Për "Gazeta Shqiptare", administratori i përgjithshëm i Konfindustrisë së Shqipërisë, Gjergj Buxhuku ka folur lidhur me këtë vendim. Ndër të tjera ai ka thënë se ky është vendim i duhur, por i vonuar i Kosovës. "Taksa është e drejtë, por e vonuar. Vendimi i marrë justifikohet plotësisht, kjo në radhë të parë, sepse Serbia është e para që ka prishur rregullin e tregtisë së lirë në dy shtylla kryesore. E para: Ka 4-5 vite që ka bllokuar linjën e interkonjeksionit Shqipëri-Kosovë. 400 kw që të vihet në funksionim ku janë mbi 70 mln euro të financuara nga Shqipëria dhe Kosova për ndërtimin e linjës, e cila është për të gjithë rajonin, për sistemin energjetik rajonal. Edhe Shqipëria edhe Kosova paguajnë gjithë kreditë e marrë gjatë gjithë këtyre viteve pa punuar. Gjithashtu, këto janë humbje të llogaritura prej dhjetëra miliona eurosh për Shqipërinë dhe Kosovën nga mosvënja në punë e kësaj linje. Si pasojë edhe vendimi që mori qeveria e Kosovës është i drejtë dhe mbështetet edhe në rregullat e reciprocitetit të tregtisë, në rast të shkeljes së marrëveshjeve. Së dyti, sipas një fakti të padiskutueshëm, produktet serbe në rajon jo vetëm në Kosovë janë produkte të subvencionuara në kundërshtim me parimet e tregtisë së lirë, gjithashtu, edhe me politikat "Tamping". Për

Kreu i Konfindustrisë: Serbia ka prishur rregullin e tregtisë, taksa e drejtë, por e vonuar "Duhet hapa gjigante për të ngritur tregun e përbashkët"



Kreu i Konfindustrisë, Gjergj Buxhuku

2 ARSYE PSE 'PRO' TAKSES

1. Ka 4-5 vite që ka bllokuar linjën e interkonjeksionit Shqipëri-Kosovë. 400 kw që të vihet në funksionim ku janë mbi 70 mln euro të financuara nga Shqipëria dhe Kosova për ndërtimin e linjës, e cila është për të gjithë rajonin, për sistemin energjetik rajonal.
2. "Si pasojë edhe vendimi që mori qeveria e Kosovës është i drejtë dhe mbështetet edhe në rregullat e reciprocitetit të tregtisë, në rast të shkeljes së marrëveshjeve. Sipas një fakti të padiskutueshëm, produktet serbe në rajon jo vetëm në Kosovë janë produkte të subvencionuara në kundërshtim me parimet e tregtisë së lirë, gjithashtu, edhe me politikat "Tamping".

këto dy arsye unë mendoj që lëvizja është e drejtë por edhe e vonuar", - ka thënë Buxhuku. Ndërkohë që pyetjes lidhur me fatin e eksportimit të mallrave shqiptare për në Kosovë ai është shprehur: Duke pasur parasysh se Kosova deri para pak kohësh importonte nga Serbia 450 mln euro në vit duke shtuar kështu edhe 70-80 mln euro që i importonte nga Bosnje-Hercegovina, mund të themi se është një shifër e konsiderueshme për Kosovën, janë gati 550 mln euro. Këto janë hapësira të cilat potencialisht mund të shfrytëzohen mirë nga prodhuesit e Shqipërisë dhe Kosovës për të rritur kapacitetet e tyre të prodhimit dhe për të plotësuar këto importe të cilat nuk do të vijë më nga Serbia dhe Bosnja por që mund të shfrytëzohen nga prodhuesit e brendshëm. Ky prodhim mund të vijë nga Shqipëria por edhe nga vetë Kosova. Ata kanë mundësi të prodhojnë më shumë për të plotësuar këtë hapësirë boshe potencialisht, e cila duhet të lihet nga Serbia. E vetmja gjë që duhet të bëjë Shqipëria dhe Kosova është që duhet të bëjnë hapa gjigandë përpara për të ngritur

tregun e përbashkët Shqipëri-Kosovë", - ka thënë administratori i përgjithshëm i Konfindustrisë së Shqipërisë. Ndërkaj Buxhuku është shprehur, gjithashtu, se ka komunikuar me prodhuesit shqiptar pas këtyre zhvillimeve në Kosovë. "Në përgjithësi, ata prodhues, të cilët nuk kanë interesa direkte, që bëjnë importe nga Serbia, ata e kanë mbështetur, në parim këtë vendim". Pra, Gjergj Buxhuku e shikon masën për taksimin me 100% të vlerës produktet serbe si një mundësi për bizneset shqiptare, të cilat mund të depërtojnë më lehtësisht në tregun kosovar. Për Konfindustria-n masa e marrë nga qeveria e Kosovës është e drejtë, por e vonuar në kohë. Ai rikujton shkeljen e herë-pa-herë nga Serbia të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë që nga bllokimi i linjës së interkonjeksionit e deri te politika e padrejtë që bën me subvencionimin e produkteve bujqësore serbe në mënyrë që të kenë çmim më të ulët se rajoni. Vendi ynë ka eksportuar këtë vit në tregun kosovar 180 milionë euro, kundrejt 550 milionë eurove produkte që kanë hyrë nga Serbia dhe Bosnja.

Rrëfhet drejtori: Jemi të kënaqur, por jo të ngazëllyer

Dorian Çene:

"Balkan Contemporary Music Festival", ja risitë e festivalit që bëri bashkë të gjithë rajonin

"Koncerti në Vlorë rezultoi i suksesshëm"

Egla Xhemali

Një festival i përmasave të mëdha u rikthye për publikun me edicionin e tij të dytë. "Balkan Contemporary Music Festival", i organizuar nga Shoqata e Kompozitorëve Shqiptarë (A.C.A), synon nxitjen e bashkëpunimit nëpërmjet njohjes "nga brenda" mes muzikantëve në rajonin e Ballkanit dhe mbështetjen, kësaj, të një tregu të qëndrueshëm të zhvillimit të muzikës bashkëkohore në rajon. Sipas gjykimit të tyre, kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet krijimit të kontakteve mes artistëve, në këtë rast shoqatave të kompozitorëve, dhe interpretimit reciprok të veprave të autorëve të rajonit. "Balkan Contemporary Music Festival" edhe në këtë edicion zhvillon idetë fillestare, mbi të cilën është themeluar, pra promovimin e muzikës artistike bashkëkohore të kompozitorëve të vendeve të Ballkanit e në mënyrë të veçantë të atyre shqiptarë. Për këtë organizim të jashtëzakonshëm ne biseduam me Dorian Çenen që është drejtori i festivalit. Ai na tregoi për risitë, për pritshmëritë që patën për festivalin, si dhe për edicionin e tretë. "Deri më tani mund të themi se jemi të kënaqur, por jo të ngazëllyer" - thotë Çene. Edicioni i tretë, pohon ai, do të mbahet më 2020 për t'1 lënë kohë prurjeve të reja. Ky organizim nuk përjashtohen mundësinë e pjesëmarrjes së artistëve nga vendet e Europës e më tej.

"Balkan Contemporary Music Festival" u rikthye këtë vit në edicionin e tij të dytë. Cila ka qenë risia e këtij viti?

Balkan Contemporary Music Festival pikë së pari i qëndroi besnik idesë fillestare mbi të cilën edhe është themeluar. Pra, në vija të përgjithshme festivali synon promovimin e krijimtarisë së kompozitorëve të rajonit. Gjithashtu, pritshmëritë tona, të cilat sigurisht që



nuk mund të përmbushen plotësisht në vetëm dy edicione, janë që të mund të kemi një treg të qëndrueshëm muzikor rajonal me fokus veprat e kompozitorëve Ballkanas. Sigurisht që kjo krijimtari nuk shihet si e veçantë nga ajo botërore por, të paktën me sa konstatojmë, interpretohet shumë pak çka mund të krijojë pikëpyetje për të ardhmen e trashëgimisë së muzikës artistike në vendet tona dhe identitetit artistik. Sikurse dhe në edicionin e mëparshëm, çdo vend pjesëmarrës ka pasur një mbremje në dispozicion ku, në marrëveshje me shoqatën e kompozitorëve të vendeve të rajonit ose edhe me vetë interpretuesit, janë interpretuar vepra të kompozitorëve të vendeve respektive. Gjithsesi, programet e prezantuar nga secili prej vendeve pjesëmarrëse nuk janë kufizuar vetëm në autorët e tyre, por kanë interpretuar edhe kompozitorë të rëndësishëm botërorë sikurse dhe kanë përzgjedhur vepra nga kompozitorët shqiptarë. Kështu që një nga të rejat e edicionit të këtij viti ka qenë sigurimi i programeve më heterogjene për secilin prej mbremjeve të festivalit. Gjithashtu, ndryshe nga

edicioni i parë, këtë vit është menduar që një mbremje t'1 dedikohet krijimtarisë së kompozitorit Thoma Gaqi pra kemi pasur të bëjmë me një koncert portret, i cili synonte të paraqistë kompozitorin Gaqi të para dhe pas viteve 90.

Sa e vështirë ka qenë organizimi i një aktiviteti kaq të madh?

Organizimi i aktiviteteve të përmasave të tilla sigurisht që nuk është i thjeshtë dhe besoj se kjo është e vërtetë jo vetëm për aktivitete muzikore. Festivali këtë vit ka pasur mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe Bashkisë së Tiranës, mbështetje kjo që ka rezultuar vendimtare në radhë të parë për mbajtjen e aktivitetit, por edhe për ruajtjen cilësore të tij. Në këndvështrimin tim, në aktivitetet të tilla, elementi thelbësor për sigurimin e cilësisë, dhe në një farë mënyrë, thjeshtëzimin e punës, është cilësia e artistëve pjesëmarrës. Kjo për arsye se në fund të fundit janë ata që dalin në skenë dhe pavarësisht gjithçkaje përbëjnë elementin kryesor të suksesit apo mospuskesit të festivalit. Për fat të mirë, qysh prej edicionit të parë, ne kemi pasur partneritetin e Uni-

versitetit të Arteve duke siguruar pikë së pari, një sallë koncertesh me akustikë të mrekullueshme sikurse dhe të gjitha ambientet ku interpretet të mund të realizojnë provat e tyre. Vështirësitë më të mëdha janë ato për sa i përket marrëdhënieve të partneritetit me organizatën simotra në rajon. Deri më tani kemi një bashkëpunim shumë të mirë me shoqatën e kompozitorëve në Maqedoni dhe një fillim të mirë me atë të kompozitorëve Sllovenë. Në rastet kur nuk kemi siguruar ende marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi, të cilat për shkak të burokracive kërkojnë njëfarë kohe, jemi munduar të krijojmë kontakte të drejtpërdrejta me vetë interpretuesit.

A i ka përmbushur festivali pritshmëritë tuaja?

Deri më tani mund të themi se jemi të kënaqur por jo të ngazëllyer. Sikurse e thashë më lart, akoma nuk është mundur të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha vendeve të Ballkanit. Kjo kryesisht për arsye financiare, përveç burokracive në sigurimin e marrëdhënieve mes vetë organizatave. Festivali, sikurse e përmenda edhe më sipër, synon promovimin e krijimtarisë së kompozitorëve të të gjitha vendeve të Ballkanit. Një synim i tillë, në funksion edhe të krijimit të kontakteve mes vetë kompozitorëve dhe instrumentistëve të rajonit, mund të arrihet natyrshëm nëse siguron praninë e të gjithë aktorëve të sipërmendur në festival dhe kjo deri më tani nuk ka qenë e mundur. Me pak fjalë, qëkurse kemi venë re se një aktivitet i tillë nuk zhvillohet në asnjë prej vendeve të rajonit, ambicia jonë ishte që elementet më të mirë të muzikës bashkëkohore rajonale të mund të mblidheshin dhe të mbanin koncerte përgjatë një afati 6-7 ditor. Deri më tani janë mbajtur vetëm dy edicione dhe ne jemi të ndërgjegjshëm që duhet kohë për të bërë përfundimisht një bilanc të këtij



aktiviteti dhe të arritjeve të tij.

Në çfarë niveli është përfaqësimi i kompozitorëve shqiptarë në festival?


Sirregull Festivali nuk jep prioritet ndaj vendeve të caktuar dhe sigurisht që muzika shqiptare duhet të zërë të njëjtën hapësirë me

atë të vendeve të tjera. Gjithsesi, këtë vit është bërë një përjashtim. Sigurisht që kur flasim për hapësirën që i jepet krijimtarisë muzikore shqiptare, por në këtë rast edhe asaj të vendeve të tjera, prioritet i jepet krijimtarisë së muzikës bashkëkohore si pjesë e pandarë e zhvilli-




Morena Taraku 'djeg' "Instagram"-in me foto topless

Ajo është një nga vajzat më të "rrezikshme" në "shoë bizz"-in shqiptar. E kemi fjalën për Morena Tarakun. Bukuroshja ka vite që jeton në Stamboll, ndërsa vazhdon të jetë një personazh mjaft i përfolur sa u përket postimeve hot. Taraku, së fundmi e ka ndryshuar pamjen e saj dukshëm, duke bërë një ndërhyrje estetike në hundë, duke e zvogëluar atë. Imazhet që ndan me fansat në rrjetin social "Instagram" bëhen mjaft të diskutuara, kjo për shkak se modelja nuk heziton që shpeshherë të ekspozohet. Me ndryshimin që ka bërë në fytyrë, Morena ka vendosur të shfaqë një set fotografik. Ajo ka publikuar disa foto në rrjetet sociale, ku shfaqet topless. Nuk kanë qenë të pakta komentet pozitive ndaj bukurioses.



Luana Vjollca është gati për të bërë ndryshimin në pamje

Luana Vjollca i habiti të gjithë kur vendosi që të ndryshonte ngjyrën e flokëve nga bionde në brune. Këngëtarja dhe prezantuesja Luana Vjollca para disa vitesh bëri një ndryshim drastik në pamje, pasi u rikthye në grupin e bruneve e më pas i ndryshoi sërish duke i bërë bionde. Siç duket, bukurshja nuk po gjen rehat dhe po mendon t'i bëjë të kuqe. Të paktën këtë ide i ka dhënë një fans së fundmi në "Instagram". Ajo ka kërkuar ndihmën e fansave. Do na pëlqente ta shihnim me flokë të kuqe që t'i thoshim "Ngjyra e kuqe shumë i ngjan".



tohen fondit të krijimtarisë muzikore shqiptare.

Kur e parashikoni mbajtjen e edicionit të tretë dhe a do të jetë edhe ai i kufizuar vetëm tek muzikantët e rajonit?

Festivalin e radhës ne e parashikojmë të mbahet në 2020. Kjo për arsye se, si një festival i përdyvitshëm dhe, qëkurse kryesisht synon prezantimin e kompozitorëve të rajonit të Ballkanit, në këtë mënyrë mund të ketë kohën e mjaftueshme për të pasur prurje interesante. Gjithsesi festivali, sikurse dhe në dy edicionet e para, nuk përjashton pjesëmarrjen e artistëve nga vendet e Europës e më tej. Kështu në edicionin e këtij viti ne kishim një trio mjaft interesante fizarmonikash nga Itali e cila, me mbështetjen e Konsullatës së Përgjithshme Italiane në Vlorë, mbajtën një koncert mjaft interesant. Sigurisht që synimet për edicionin tjetër kanë të bëjnë me një përfaqësim të më shumë vendeve dhe zgjerim të shtirjes së festivalit. Këtë vit eksperimentuam me mbajtjen e një koncerti në qytetin e Vlorës çka na rezultoi mjaft pozitive. Në edicionet e tjera shpresojmë të mundësojmë koncerte edhe në qytete të tjera. Në fund të fundit, njohja e krijimtarisë muzikore dhe interpretuesve të rajonit, i duhet ofruar edhe banorëve të qyteteve të tjera të Shqipërisë përveç Tiranës.

Ledri Vula befason fansin, zbuloni çfarë surprize i ka bërë

Ledri Vula është një nga reperat më të dashur të momentit. Ai ka surprizuar një djalë nga Prishtina me emrin Ardi, fans "i çmendur" pas këngëtarit të njohur. Dëshira e tij për ta takuar është realizuar mbrëmë, derisa reperi po ndiqte një ndeshje basketbolli në kryeqytet. Fansi i Ledrit për fat të keq është i palëvishëm dhe mund të ecë vetëm nëpërmjet karrocës, ndërsa reperi ka qëndruar krah tij gjatë gjithë ndeshjes. Ledri ka bërë një gjest të jashtëzakonshëm, duke i qëndruar pranë djalit që e kishte me shumë dëshirë ta takonte një ditë.



meve të shoqërisë së sotshme. Kjo jo për të bërë diferencime mes epokave të ndryshme, por është pikërisht kjo krijimtari që, në gjykimin tonë, nuk interpretohet mjaftueshëm dhe shpesh herë, për shkak të mosnjohjes që vjen nga ky mosinterpretim, është e paragjykuar.

Për t'u kthyer te vëmendja që i kushtohet muzikës shqiptare në festival, në këtë edicion ka pasur një përjashtim në raport me edicionin e parë. Në radhë të parë, nata e muzikës shqiptare, sikurse thashë edhe më lart, iu dedikua krijimtarisë së kompozitorit Thoma Gaqi. Njëherazi menduam që të mbanim një natë të dedikuar

për kompozitorë shqiptarë më të rinj. Kjo për arsye se, ndërkohë që mundësitë e interpretimit të veprave të kompozitorëve të afirmuar shqiptarë janë të pakta, këto mundësi për kompozitorët e rinj janë inegzistente. Rrjedhimisht këtyre të fundit iu dedikuar një mbrëmje e veçantë në mënyrë që të sigurojë një pjesëmarrje më e gjerë dhe t'ju jepej mundësia, bazuar në meritat individuale, sa më shumë krijuesve të rinj. Në këndvështrimin tim kjo ishte një ndër mbrëmjet më interesante për arsye se pjesa më e madhe e veprave të interpretuara ishin vepra të reja dhe, kështu, kemi të bëjmë me vepra të cilat i sh-

INTERVISTA

PRIMO SHLLAKU: 1968, takim me Boudler-in përmes një libri të shqepur

Fatmira Nikolli

Si nisi përkthimi i veprës "Lulet e së Keqes" dhe pse zgjati 50 vjet

Përmes një dere gjysmë të hapur, studenti i dikurshëm kujton një sirtar që hapej. Dy duar mbështjellin diçka me gazetë. "Pakaja" i jepet në dorë kur rruga boshatiset pas një ecjeje që kontrollon kalimtarët. Mes mëdyshtës e drojës porositet të ketë kujdes. Askush veç tij s'duhet ta shohë.

50 vite më pas, Primo Shllaku është thijnur, ka mbërritur moshën e profesorit dhe ka në duar të përkthyer në shqip, "Lulet e së Keqes" së Boudler-it (Botimet Albas). Historia e një libri të shqepur, pa kapakë, që ai e hapi ta lexonte tekta shkante me tren në Elbasan tanimë vjen e rrëfyer në vetë të parë, nga poeti përkthyes. Primo Shllaku, ka paraqitur në panairin e fundit, 5 vepra të përkthyer, rezultat i netëve të gjata para fjalorëve, mbi vargje që duhej të tingëllonin shqip, po aq mirë sa në gjuhët që ishin shkruar.


Historia e tij, nis para një zupi në kafe "Florën" e dikurshme. Kishte përballë latinistin Henrik Lacaj.

Botuesja e Albas, Rita Petro, shënonte pak ditë më parë se "Një nga punët më të çmuara në këtë panair të librit është bashkëpunimi me Primo Shllakun për të sjellë në shqip veprën e plotë "Lulet e së Keqes"; një punë e mundimshme përkthimi disaveçare për të harmonizuar muzikën dhe domethënien e thellë të vargut bodlerian me tingëllimin e bukur në gjuhën shqipe".

Ndërsa vetë Shllaku, vë në dukje se "më interesonte një Baudelaire esencial dhe për të kam ba përpjekje konstante dhe të përvijueshme. Rezultati asht ai që shifet. Vlerësimi i tij nuk asht në dorën time. I mbetet lexuesit dhe kritikës. Lexuesin e kemi goxha memec, kurse kritikën goxha inkuzistente. Punët tona kanë mbetet me hypë në peshore diku në ndonji datë mbas vdekjes. Nji shkak ma shumë për me ia ba hysmetin jetëgjatësisë. Rrofët jeta pra e poshtë peshoret".

-Që kur ju ka lindur ideja të merreshit me tekstet poetike të Baudelaire-it?

Në vitet e shkollës së naltë, aty nga 1968, flitej intensivisht për poetët francezë të avangardës, ndër të cilët Baudelaire-i mbahej si nismëtar. Flitej edhe për "Lulet e së Keqes" si për një legjendë, por tekstet e tij gjendeshin me pikatore vetëm në formë citimesh të



"Do ketë edhe një botim dygjuhësh frëngjisht-shqip, për lavdinë ose turpin tim"

vogla me korsiv, ose ndokush mbante mend vetëm "parajsat e tij artificiale" si e vetmja lavdi e tij.

Nji herë, në nji takim timin me profesorin e nderuem, mikun e prindëve të mi, latinistin e shquem, Henrik Lacaj, me të cilin kisha krijuar edhe unë nji marrëdhnie të mirë të natyrës pedagog-student.

Mbaj mirë mend se po hanim nga nji zupë tek "FLORA" dhe aty e pyeta nëse mund të më thoshte diçka rreth këtij autori për të cilin pak dija edhe sa i përket kronologjive të tij. "Asht romantik në thelb, më tha, por nismëtar i modernisë dhe njeri me jetë shumë të trazuese". Fjalë e tij më ndezën edhe ma tepër. Krejt papritmas ai më tha: "E kam në shpi nji botim

të keq të "Luleve të së Keqes". "Si i keq?" e pyeta unë. "Asht i shkapan fletësh dhe pa kopertinë," më spjegoi prof. Henriku. "S'ka gja prof." u hodha e i thashë, "e rregulloj unë, se due ta kopjoj." Profesori qeshi në hundë dhe nuk e zgjati ma. Mbaj mend që pati nji pauzë mendimi.

- Kur e more librin?

Nji herë tjetër e takova në fakultet dhe më tha të shkoja me të në zyrën e pedagogëve. Shkova mbas tij. Ai hyni mbrendë dhe mbylli derën. Unë mbeta jashtë. Dikush hapi prap derën për të dalë dhe unë e shquejta profesor Lacajin që po hapte me çelës nji sirtar të nji rafti sirtarësh në katin e tij ma të naltë.

Doli me diçka të pëshpëllë me gazetë dhe u nisëm. Rrugës kur e hetoi se nuk kishin shumë njerëz rrotull, ma dha gjanë e pëshpëllë me gazetë. "Kije kujdes se asht vetëm për ty e tjetërkujt s'i duhet gja." E shikova në fytyrë profesorin tim dhe pashë të ndeme në të njiilloj kujdesi e mëdyshtë. "Mos kij gajle, profesor, se do ta rregulloj dhe do ta kthej për pak kohë." "Mirë", tha ai dhe i shndritën sytë.

Në fundjavë u nisa për Elbasan, ku asokohe banoja familjarisht dhe e hapa gazetën me sendin e çmueshëm në të. Ishte nji libër i shkatërruem fletësh, ose nga lexime të shumta e prej duersh të ndryshme, ose nji libër që kishte ra nga avioni, kaq i shqepun dhe i çapërdisur ishte.

Masëpari u mora me lidhjen e tij. E pruna në fe. E lidha dhe i vuna nji kopertinë të fortë prej faeziti, të cilën e mbuloja me nji kadife brazba-brazda ngjyrë jeshile si të ishte ndonji libër fetar i bektashijve. Mbasi mori formën e nji libri të fortë e solid, e çova tek piktori i teatrit "Skampa: Enver Voci, i cili shkroi me bojna voji emnin e autorit, zi mbi nji sfond të verdhë "Baudelaire".

- Ia ktheve më librin profesorit?

Këtë libër e kam edhe sot. Nuk ia çova kurr të zotit. As ai nuk ma kërkoi. Mendoj se po të mos isha marrë me kthimin e ktij autori në shqip, akti i mosdorëzimit do të kishte qenë akti i pastër vjedhje. Por mbajta e tij për të dhanë mbas pesëdhjetë vjetësh nji variant timin të "Luleve", ma lehtëson disi ndërjegjen dhe unë mendoj thania kineze se "të vjedhësh libra asht nganjherë virtut".

- Cila ishte përshtypja jote e parë për tekstin e Baudelaire-it?

Nivelet e mia të njohjes së gjuhës frënge ishin modeste me gjithse kisha lexue shum autorë të prozës e të poezisë. Por Baudelaire-i me lente jashtë dhe unë vetëm tek-tuk entuziazmohesha prej ndonji vargu ose strofe të cilën unë e perceptoja simbolikisht sic e donte ai, por vetëm literalisht dhe vetëm. Mbaj mend se më patën përshtyp shumë vargje si "Lulet shtrëngata i rinon", ose strofa e famshme e poemës "Shatërvani prej gjaku".

Te dashnia kërkova nji gjumë harrese prora, por dyshek gjilpanash dashnia më doli,

i bamë me i dhanë me pi ktyne bija mizore.

Sprovat e mia të para për me e kthye në shqip Baudelaire-in ishin nji shtrimje e tyne lineare në prozë, në përpjekje për me gjetë kuptimin dhe semiologjinë e var-



gut të tij. Por mund të them me siguri se dy ose tre variantet e para ishin komplet të mbushuna me keqkuptime dhe me pasaktësi të tekstit bodlerian.

- Ishte e vështirë të tingëllonin shqip apo nuk kishë me se ta krahasojë?

Vetëm mbas 1990 kur rashë në kontakt me tekste italishte dhe anglishte të ktij poeti vuna re se sa larg ndodhesha në qëllimin tim për ta dhanë kuptimin dhe imazhin piktorik të vargut bodlerian. Sidomos më ndihmuen pa masë tekste frënge spjeguese me destinacion shkollor që spjegonin dhe përimitonin gjithçka tek ky autor. Tekstet e Baudelaire-it ishin të mbushun me fusnota dhe kishin shum aparat leksikor. Spjegoheshin jo vetëm emna dhe personazhet të rangut të dytë të mitologjisë greke, por edhe fjalë të rralla që autori i përdorte me qëllim stilistik apo edhe për të realizue rimat.

Mu deshën rreth njizet vjet për me hy si i sigurtë nën strehën e gjanë poetike të Baudelaire-it dhe me undie atje si i shtëpisë. Ndërkaq kisha lexue studime rreth veprës së poetit dhe biografë të shquem të tij. Por kisha fillue edhe përkthimin e esesë së jean-paul Sartre-it lidhë me Baudelaire-in, të cilën kisha ambicion ta botoja njkohësisht me "Lulet e së Keqes". Për fat të mirë edhe këtë pikësynim e realizova falë bashkëpunimit me Rexhep Hidën, i cili e nxori në panairin e sivjetshëm këtë vepër pak të njoftun të Sartre-it, që në të vërtetë asht nji sprovë për nji psikologji ekzistencialiste.

- Cili ka qenë stili i punës me



tinglloresh nuk ka qenë ndihmuese në zgjidhjen e adekuatësive formale në përkthim. Pra, që në krye të herës më asht dashtë me vendosë kriteret përkthimi, tue u nisë nga bindja progresive se dhania në shqip e një Baudelaire-i total ishte e pamundun. I nisun nga përvoja e maparshme e përkthyesve të baudelaire-it në shqip, ku nevojat e rimës dhe të izosilabizmit, të vendosuna si kriter parësor, e detyronin përkthyesin ta "frynte" vargun ose, cka asht edhe ma e keqja, të "shpiknin" fjalë për të sajue takimin "fatlum" të rimës. Këtë dukuni unë e kam përjashtue pothuajse gjithkund. Më interesonte një Baudelaire esencial dhe për të kam ba përpjekje konstante dhe të përvijueshme. Rezultati asht ai që shifet. Vlerësimi i tij nuk asht në dorën time. I mbetet lexuesit dhe kritikës. Lexuesin e kemi goxha memec, kurse kritikën goxha inekzistente. Punët tona kanë mbetë me hypë në peshore diku në ndonji datë mbas vdekjes. Nji shkak ma shum për me ia ba hysmetin jetëgjatësisë. Rroftë jeta pra e poshtë peshore!

- Çfarë të thotë vetndjema? Sa ia le arritur e sa i kënaqur je me këtë që ti e ke qajtur vepër jete?

Unë shkruaj për vete poezi dhe tashti i ka ardhë radha edhe vëllimit tim të katërt me poezi. Si i tillë gjatë përkthimit e kam ndie veten në fushën time të lojës e të krijimit. Mbatja në dorë kaq gjatë, në mos tjetër, dëshmon sigurisht për ndjenjen time të naltë të përgjegjësisë. Së dyti, unë gjatë gjithë kohës kam qenë syhapun në atë që arrija të jepja në çdo stad të marrjes time me tekstet e poemave të Baudelaire-it. Ngadalë e ndieja se mbi "telajon" time të shqipes po rreshtoheshin "virtute" adekuate të poezisë së tij. Në fazën time të fundit, pra këto dhjetë vitet e fundit, i sigurt se e kisha zotnue semiotikën e poetit, pata ngenë të merresha me formën dhe kryesisht me rimat dhe izosilabizmin në funksion të ritmisë sipas metrave klasikë të shqipes. Nderkaq për shkak të probiliteteve të mëdha që jep një teks kaq i pasun me vargje, disa rima ishin dukë prej vetiu dhe shkëlqenin për natyrshmëri e vetvetishmëri në tyne. Diku tjetër me anë inversionesh ose prejshës të lehta sinonimike ose parasonimike kam arritë të shtesoj rima të plota, por edhe asonanca tingluese. Diku tjetër vargu ka dalë tronk dhe organizimin vjershëror e ka marrë ritmi që asht edhe shpirti i fundit i poezisë.

- Si u binde ta dorëzojë?

Kohët e fundit po e ndieja se nuk kisha ma se çfarë të shtoja e çfarë të ndreqja në të. Ky ishte edhe çasti kritik. Duhet ta vendosja botimin. Palë dashamirësisë dhe gatishmërisë së Ardian Marashit që më rekomandoi, veprën time e çoi në destinacion botuesja dhe poetesha Rita Filipi. Dhe jemi ktu në këtë pikë. Pra stadin e parabolimit kjo vepër nuk ofrohej ma për përmarirësi. Mbase drita e botimit ka sugjerime të reja. Së shpejti do të përgatisim së bashku me z. Rita Petro dhe shtëpinë botuese ALBAS një botim luksi (version dhurate) të "Luleve së të Keqes" me kopertinë hard-cover dhe me veshje lëkure. Nga ana e mbrendshme botimi do të jetë dygjuhësh, majtas teksti frëngjisht sipas origjinalit dhe djathtas, për lavdinë ose turpin tim, teksti shqip.

VARGJET
Marrëzia, gabimi, mëkati, tamahu
na zaptojnë shpirtnat e trupat na i punojnë.
E na vesh ujqejmë brengat tona të ambla
sikurse lypsarët ushqejnë krymbat e vet.
Mëkatet tona - kryeneçe, prej spurdhjakësh pendimet,
e trashë i paguejmë të gjitha dëshirat.
Me gëzim u hymjë rrugëve të përbalt'na
Me besë se 'i lot i lan të gjithë njollat tona...

tekstet bodleriane?

Aritmetikisht jam marrë rrumbullak 50 vjet, 1968-2018. Ka qenë nji punë me stilin: puno e lene të pushojë. Kam përmby 10 ose 12 variante përkthimi të poemave të ndryshme. Sidomos më kanë mundue për t'i sjellë në shqip poemat e tij emblematike si "Njeriu e deti", "Zgalemi", "Gjegjësitë", "Coftina", "Udhëtimi në Kithërë", "Udhëtimi" etj.

Kam qenë i ndërgjegjshëm që të mos sakrifkohet asgja nga vegimi piktorik dhe imazhineria e autorit për asnji kërkesë formale si rima ose asonanca. Kam synue esencialitetin e vargut dhe jo frymjen e tij. Kam synue pikturen dhe jo pershkrimin. Kam synue kadencen dhe jo harmonikat muzikore kur ato nuk vinin natyrshëm. Shqipja jonë si gjuhë me theks të lirë tonik dhe e mbushun me ganglione bash-

110 VJET NGA KONGRESII MANASTIRIT



Kongresi i Manastirit ishte një kongres kombëtar, i cili u mbajt në Manastir më 14 nëntor deri më 22 nëntor të vitit 1908. Kongresi i Manastirit vlerësohet si kuvendi më i rëndësishëm kombëtar në historinë politike e kulturore të shqiptarëve në fillim të shek. XX. Ky kongres u mbajt për të shqyrtuar disa çështje të rëndësishme të lëvizjes kombëtare, në radhë të parë u paraqit me rëndësi shqyrtimi i çështjes së alfabetit të gjuhës shqipe. Në të morën pjesë 50 delegatë të shoqërive, klubeve dhe organeve kombëtare të trevave shqiptare.

Kongresi ngriti një komision prej 11 delegatësh ku Gjergj Fishta u zgjodh kryetar komisioni. Në këtë komision ishin anëtarë: N. Mjeda, Gj. Qiriaz, M. Frashëri, S. Peçi, Sh. Kolonja, L. Gurakuqi, Dh. Buda, B. Topulli, N. Vriioni, G. Cilka.

Pas mjaft diskutimesh u krjuua një alfabet i ri, i mbështetur i tëri në alfabetin latin. Në

fund komisioni dhe kongresi vendosën që të lejohen si përdorimi i alfabetit të Stambollit, që kishte një përhapje të gjera, ashtu si dhe alfabeti i ri. Brenda pak vitesh alfabeti i ri u bë alfabeti i përbashkët e i vetëm për gjithë shqiptarët, që është alfabeti i sotëm i gjuhës shqipe.

Në këtë kongres u morën vendime të rëndësishme për çështjen e alfabetit e për ato politike, që ndihmuan për ngritjen në një shkallë më të lartë të kulturës e të arsimit shqiptar, si edhe për bashkimin e tij të mëtejshëm në luftën për çlirim kombëtar.

PERIUDHA E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI 1945-1990", SI TI QASEMI TË KALUARËS?

Në kuadër të programit Edukimi Përmes Kulturës, Muzeut Historik Kombëtar organizoi veprimtarinë "Një pasdite në muze" me temë: "Periudha e komunizmit në Shqipëri 1945-1990, si t'i qasemi të kaluarës?" Këto takime periodike bëhen me qëllimin për të sensibilizuar shoqërinë shqiptare për këtë temë të ndryshme të historisë, kulturës dhe trashëgimisë kombëtare shqiptare. Për të referuar për këtë temë ishin të pranishëm Prof.As.Dr. Sonila Boçi, shefe Departamenti pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Dr. Dorian Koçi, Drejtor i Muzeut Historik Kombëtar, Etleva Demollari, Drejtoreshë e Muzeut Kombëtar "Shtëpia me Gjethe" si dhe sociologjia Entela Binjaku.



Në fjalën e tij, Drejtori i Muzeut Historik Kombëtar, Dr. Dorian Koçi, tha se, "Në vendet totalitare propagandë dhe terrori paraqet dy anë të së njëjtës monedhe. Kudo që totalitarizmi zotëron kontroll absolut, ai zëvendëson propagandën me indoktrinimin dhe e përdor dhunën jo aq sa për të frikësuar njerëzit, sesa për të realizuar vazhdimisht doktrinën e tij ideologjike dhe gënjeshtrat e tij praktike. Në Shqipëri i gjejmë të gjitha format e komunizmit dhe një ndikim të madh ka pasur stalinizmi, e cila ka qenë ideologji sunduese. Në jetën politike regjimi komunist shqiptar ndoqi verbërisht përvojën sovjetike. Shqipëria ishte vendi socialist me diktaturën më të egër në

drejtoreshë e Muzeut Kombëtar "Shtëpia me Gjethe" tha se çdo trashëgimi duhet mbrojtur pa dallim nga Holivudi të Holokausti. Ajo foli edhe për muzeun e kujtesës që ajo drejton dhe për programet e ndryshme që zhvillohen me personat e prekur nga ai regjim, por edhe aktivitetet e shumta që zhvillohen me shkollat, përmes programeve edukative.

Sociologjia, Entela Binjaku, prezantoi këtë aktivitet dhe u shpreh se, komunizmi është një temë e cila më shumë se çdo temë tjetër ka nevojë të trajtohet me objektivitet.

Muzeu Historik Kombëtar organizon këtë takim shkencor-social me një natyrë periodike, për të përkujtuar figurat të shquara të historisë dhe të letërsisë shqiptare, ballkanike dhe europiane që kanë shkruar dhe kanë kontribuar për evidentimin e vlerave kulturore. Studentët e vitit të parë të Fakultetit të Mjekësisë, të pranishëm në këtë veprimtari, kishin përgatitur pyetje të tyre, duke marrë përgjigje nga ana e ligjëruesve.

Kudo që totalitarizmi zotëron kontroll absolut, ai zëvendëson propagandën me indoktrinimin dhe e përdor dhunën jo aq sa për të frikësuar njerëzit, sesa për të realizuar vazhdimisht doktrinën e tij ideologjike dhe gënjeshtrat e tij praktike.

Opinion *i* Ditës

Ç'ndodhi në mbledhjen e parë të qeverisë ku unë mora pjesë?

Nga Taulant Muka

(vijon nga faqja 1)

... shënime. Pjesa e parë ishte formale, KM i vendit lexonte vendimet dhe vetë pohonte "Miratohet". Pas kësaj pjese formale, u lumturova sepse kishte një minutazh të caktuar për diskutim dhe tema ishte: "Performanca e ministrive". Ku ka temë më të bukur dhe më të rëndësishme se kjo. Mendova vlerësues i performancës do ishin objektivat, zbatimi i reformës, por jo. Në ekran projektohet një tabelë, ku në krah të majtë ishin renditur ministrinë, dhe përkrah çdo ministrie ishte numri i "Pëlqimeve" (Likes), Shpërndarjeve (Shares) në "Facebook", "Retweet" në "Twitter" dhe "Pëlqimet" në "Instagram". O Zot mendova, ku jam?! Ndërkohë që vendi im ka shumë probleme ekonomike dhe sociale, qeveria shqiptare harxhon kohë të vlefshme dhe diskuton "Pëlqimet" dhe "Shpërndarjet" në rrjetet sociale?!

Kryeministri i vendit mbajti 20-30 minuta diskutim për performancën e dobët që ministrinë kishin bërë në rrjetet sociale dhe se ishte skandalozë që kishte dhe zv.ministra që merrnin 2 pëlqime (Likes). Të gjithë mbanin shënime, askush nuk fliste. Madje, aty mësova që çdo ministri kishte një grup "WhatsApp"-i me pjesëtarë stafet e ministrive, drejtorive dhe mili-



tantëve politikë, ku lajmërohej postimi në rrjetet sociale i një lajmi dhe ju kërkohet ta pëlqenin dhe shpërndanin.

Shumë pak shqiptarë e kuptojnë

arsyen pse kjo është e rëndësishme. Qeveria shqiptare lufton për formën (fasadën) dhe jo përmbajtjen (zbatimi i reformës, treguesit ekonomik, cilësia në arsim etj.). Perceptimi për

Shqipërinë jashtë vendit është i rëndësishëm për politikën shqiptare dhe i vetmi perceptim që për ta ka vlerë. Prandaj është e nevojshme të ketë sa më shumë

përhapje të "fasadës", e shitur si arritje në rrjetet sociale. Bota perëndimore, përmes aplikacioneve të veçanta bazuar në metodat e inteligjencës artificiale, vlerëson gjendjen e vendit tonë (dhe shteteve të tjera) dhe përkrahjen që një forcë politike apo lëvizje ka në rrjetet sociale (përkthimi i statusit bëhet automatikisht në gjuhën angleze), gjë që nuk mund ta bëjë përmes medias vizive dhe të shkruar, të cilat janë në gjuhën shqipe dhe mund të kontrollohen (sikurse ndodhë në vendin tonë). Kjo është arsyeja pse fshihen mesazhet negative në statuset e qeverisë dhe pjesëtarëve të saj, apo edhe ndoshta beteja e qeverisë për "Shpifjen". Duhet dhënë imazhi perfekt për Shqipërinë jashtë vendit, pak rëndësi ka realiteti faktik dhe çfarë mendojnë vetë shqiptarët. Shikoni Tiranën sot, duket shumë bukur kur përshkon rrugën nga aeroporti deri në qendër dhe korpusin universitar (i cili ka fasadë të bukur, por po të hysh brenda, gjendja është skandalozë). Kjo është dhe rruga që çdo zyrtar i huaj bën kur viziton Shqipërinë, duke ikur me përshypjet sikur Shqipëria po ndryshon! Prandaj dhe beteja e shqiptarëve sot për të vërtetën, kur nuk ka opozitë të fortë dhe dija po shkatërrohet, është edhe beteja në rrjetet sociale... fatkeqësisht. Kjo është një beteje në të cilën shkenca (metodat e inteligjencës artificiale) mund të ndihmojnë!

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinioni *i* Ditës

FMN erdhi, pa iku


Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... shqiptare dhe me ekonominë tonë: atë të vëzhguesit, mbi bazën e Nenit 4 të marrëveshjes FMN-Shqipëri. Edhe pse ishim në prag të krizës së fajdeve, raporti i misionit fliste për ekuilibër të qëndrueshëm makroekonomik. Një gjuhë Ezopi, e përdorur në shumë vende të botës rëndom në atë kohë. Fondi bënte kujdes të mos i acaronte marrëdhëniet me qeverinë, që rrezikonin jo pak në politikën e tyre ekonomike. Shumë ujëra kanë rrjedhur që atëherë. Sidomos pas krizës greke të borxhit publik të nëntorit 2011, FMN është bërë më e drejtpërdrejtë dhe gjuha e raportimeve në publik të misioneve të saj, më kurajoze. Kuraja e misioneve të saj bëri që Hungaria për një kohë të mos i pranonte shërbimet e misioneve të Fondit. Po ashtu, qeveria ruse ka treguar pakënaqësi ndaj FMN-së dhe jo në pak raste ka qenë në prag të kërkesës për të larguar misionet e tij.

Në mars të këtij viti, deklarata përmbylëse e misionit të parë të monitorimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (sipas pozicionit të tanishëm të Fondit në raport me qeverinë tonë, ai mund të bëjë dy misione vëzhgimi në vit), ngriti disa shqetësime madhore. Ajo theksonte: "Duke pasur parasysh nivelin e lartë të borxhit publik (71,2 për qind e PBB-së në fund të vitit 2017, përfshirë edhe detyrimet e prapambetura të qeverisë qëndrore dhe vendore prej 1,8 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto të vendit, tronditje të tilla negative si ngadalësimi i rritjes ekonomike, i ndërthurur me prime më të larta risku të interesave dhe zhvlerësim të kursit të këmbimit, apo materializimi i detyrimeve të kushtëzuara, mund të japin ndikim negativ të borxhi dhe të qëndrueshmëria e jashtme, çka do të kërkonte një korrigjim të fortë fiskal". Tetë muaj më vonë, Fondi e zbuti gjuhën, megjithatë qeveria jonë është angazhuar në një garë të pashoqe Partneritetesh Publik-Privat (PPP) e koncesionesh.

Ajo ka programuar të kontrakttojë me PPP, 3 akse rrugore, 2 aeroporte, 6 shkolla në Tiranë dhe



1 spital rajonal në Fier. Kontratat në fuqi dhe ato të projektuar për vitin e ardhshëm i kalojnë 2.4 miliardë eurot. Megjithatë, FMN rihet publikisht (konferenca e përdheshme për shtyp) në kërkesën e ish-shefit të misionit të saj në Shqipëri, Jens Reinke të fillimvitit, që qeveria të mos pranojë më propozime të pakërkua për PPP-të, duke vërejtur se ekonomia po performon mirë. Urojme të jetë vërtetë kështu. Që "devijimet materiale" në informacionet publike të Ministrisë sonë të Financave dhe Ekonomisë lidhur me treguesit kryesorë makroekonomikë (deficiti buxhetor, borxhi publik), të vërejtura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në raportin më të fundit të tij në

Kuvend për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2017, i konsideruar nga vetë deputetët dhe shumë ekonomistë si ndër raportet më profesionale dhe të arrira të këtij institucioni në 7 vitet e fundit, të mos përcudnojë realitetin tonë ekonomik. Të mos na shesin sapunin për djathë.

Të mos deklarojmë kot se kemi ulur borxhin, se kemi një deficit buxhetor 1.9 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto të vendit (PBB), kur në të vërtetë, po të përfshihet detyrimet e prapambetura dhe pagesat për rimbursimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, ky deficit rritet me gjysmën e tij, shkon 3 për qind të PBB-së! Fondi mund t'i kishte thënë qeverisë sonë "përfshini pagesat e

kontratave PPP në llogaritjet për borxhin publik" (kështu e ka orientuar Komisionin Evropian dhe Audituesve në raportin e saj të marsit 2018 për PPP-të në BE), por nuk e tha. Nëse futen kontratat koncesionare PPP të nënshkruara nga qeveria jonë (arrijnë në 12.7 për qind të PBB-së) në llogaritjet për borxhin, ato e çojnë atë në 83% për qind të Produktit të Brendshëm Bruto të vendit dhe jo 69.9 për qind sa thotë qeveria jonë. Pra, shumë më të lartë se sa vetë shifra e lartë që pranoi FMN-ja se ishte (pra 71.2 për qind) për vitin 2017. Nuk na takon ne të gjykojmë arsyet e kësaj zbutjeje qëndrimesh të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Ai erdhi, pa dhe iku.

HOROSKOPI

DASHI

Sot do të ndiheni shumë të lumtur. Do të keni energji mjaftueshëm për t'u argëtuar në mbrëmje me miqtë. Nëse dikush iu jep një ide të çmendur rreth dikajke, mendojeni mirë dhe mos e refuzoni. Ecnit përpara dhe ndiqni instinktet tuaja.

DEMI

Nëse bëheni subjekt i kritikave nga miqtë dhe familjarët për veprimet tuaja të fundit rreth një divorci të mundshëm apo nisen e një marrëdhënieje të re romantike, mos u përipiq të argumentosh.

BINJAKET

Disa persona të kësaj shenje mund të jetë të trishtuar sot sa i përket lidhjes së tyre romantike. Personi që keni pranuar në jetën tuaj mund t'ju zhgënjëjë. Përipiquni të angazhoheni me dikë tjetër, në mënyrë që kjo gjë të mos ju prishë ditën.

GAFORJA

Nëse dëshironi të kaloni një ditë të qetë me familjen, duhet të rregulloni pajtësit axhendën. Do ta ndjeni të nevojshme të shprehni me familjarët tuaj. Mos u shqetësoni nëse refuzoni ftesën e dikujt. Fillimisht duhet të mendoni për veten tuaj.

LUANI

Do të përballeni me një sfidë shumë të rëndësishme sot. Ndoshta mund t'i vërtetoni dikë dikujt. Duhet të jeni krenarë për suksesin tuaj. Relaksoni dhe shijoni mbrëmjen.

VIRGJERESHA

Sot ka gjasë t'ju jepet një mundësi për t'u rritur profesionalisht. Të ardhurat ekonomike do t'ju rriten, por përipiquni të mos shpenzoni më shumë se buxheti juaj. Në mbrëmje mund të përjetoni një situatë të çuditshme dhe do ta keni pak të vështirë të dilni prej saj.

PESHORJA

Mos humbisni kohë duke dhënë argumente në shtëpi. Nëse dikush ju kritikon, mos u shqetësoni dhe kthejeni këtë situatë në shaka. Do ta kuptoni që kjo mënyrë do të funksionojë më së miri.

AKREPI

Gjatë ditës së sotme do të ndiheni shumë optimist. Gjithçka do t'ju shkojë mirë si në jetën personale, ashtu edhe në atë profesionale. Nëse jeni të martuar, do të argëtoheni me partnerin/partneren tuaj.

SHIGJETARI

Nëse nuk keni besim të vetja, përipiquni ta fshihni këtë sepe mund të ndiheni më mirë. Në këtë mënyrë nuk do ta vënë re as të tjerët, çfarë do t'ju bëjë ju ta harmoni. Nëse do të vepromi kështu, do t'ia dilni mbanë gjatë disa negociatave në punë.

BRICJAPI

Një ëndërr që e keni pasur që në fëmijëri mund të jetë drejt realizimit. Mund ta arrini këtë qëllim, por duhet të kuptoni se tashmë jeni rritur dhe nuk do t'ju falë të njëjtën kënaqësi që mendoni në fëmijëri.

UJORI

Do të qëndroni gjatë në punë për një projekt të rëndësishëm. Do të jepni maksimumin për të realizuar atë çfarë dëshironi. Kushtojani mbrëmjen familjes suaj. Nëse një mik ju fton për një mbrëmje shumë të veçantë, mos e refuzoni.

PESHQIT

Do ta kaloni ditën duke menduar rreth një plani të këndshëm për fundjavën. Dikush do të përipiqet t'ju afrohet, pasi ka ndjenja të veçanta për ju. Vlerësojeni situatën në mënyrë objektive dhe më pas vendosni.

TRAJNERI I FLAMURTARIT

Trajneri i Flamurtarit, Ilir Daja ka dalë para mediave, ku ka folur për ndeshjen e nesërme ndaj Partizanit për javën e 14 të Superiores. Ai u shpreh optimist për gjendjen e skuadrës, duke pranuar se ekipi do të luajë vetëm për fitore, ndërkohë që ka folur edhe për Elton Kalen. "Janë 2 javë të mjaftueshme, por dimë që nesër (sot) kemi ndeshje



me Partizanin kryesues deri më tani. Është ekip që ka treguar stabilitet në lojë dhe rezultate. Do të jetë e vështirë, por ashtu siç kërkojmë ata objektivat, kërkojmë edhe në rikuperimin. Nesër duhet të kemi qëndrueshmëri të madhe taktike dhe psikologjike për të shkuar te rezultati pozitive dhe 3-pikëshi, pasi jemi edhe para tifozëve tanë. Për të qenë i singertë, mungojnë Siljanovski dhe Alvesh. Thashë

Daja: Ndaj Partizanit duam tri pikët, fitojmë për tifozët

që këtë klasifikim, në këto 13 javë Siljanovski ka qenë titullar, ndërsa Alvesh më i kufizuar, por shkak dëmtimi dhe ardhjes me vonesë. Jemi mësuar dhe kemi përdorur kontingjentin që kemi. Në vend të Siljanovskit nuk kemi lojtarë që dublon, por edhe me mungesa të tjera, kemi

performuar mirë. Ndaj Skënderbeut treguam se nuk ishim inferiorë dhe na bën të mendojmë se me Partizanin do të vazhdojmë me të njëjtën performancë, duke synuar 3 pikët. Kalen e quaj blerje në periudhën e janarit, pasi edhe 4 ndeshje kanë mbetur. Na shtohet një lojtar si Kale me

vlera dhe eksperiencë, por duhet parë nesër, pasi ka 4 muaj që nuk luan. Ne jemi të bindur se tifozët janë vlerë e shtuar për lojtarët, edhe kur luajmë në transfer ta e jo më nesër. Duhet ta menaxhojmë mirë, pasi kur kemi pasur shumë tifozë, kemi pasur trysni psikologjike. Ardhja e tyre në stadium është motiv për ne, pasi në fund ndeshja luhet për ta", u shpreh Daja.

Trajneri i Partizani beson te skuadra e tij, pavarësisht se kuqezinjët janë një pengesë serioze



Jeton Selimi

Gega: Flamurtari i fortë, por ne shkojmë të qetë në Vlorë

Kapiteni Hoxha nuk ia del, e zëvendëson Xhika

Skënder Gega vlerëson maksimalisht sfidën e radhës ndaj Flamurtarit dhe kërkon impenjim total nga skuadra e tij. Pavarësisht se Partizani nuk do të ketë në dispozicion kapitenin e ekipit, portierin Alban Hoxha, Gega ka besim se zëvendësuesi i tij, Dashamir Xhika, do të jetë në gjendje të dhurojë paraqitjet e duhura. Shpërthimi i Hebagj me ekipin U-21 të Shqipërisë ka sjellë humorin e duhur te stafi teknik, që tashmë presin nga shkodrani shumë gola edhe për Partizanin.

Ka kaluar 30% e kampionatit, 31 pikë, Partizanit duket sikur ka ritëm tjetër. Është e drejtë që deri tani kanë shkuar gjërat mirë. E gjithë sfida jonë është të vazhdojmë me këtë ritëm. Me ndeshjen e radhës dua të them se është ndeshje e fortë. Luajmë përballë një klubi me emër, ndoshta nga klubet më të mira të futbollit shqiptar. Çdo gjë do t'ia lëmë fushës.

Kapiteni Hoxha do të jetë në fushë?

Nuk ka sekrete. Edhe Xhika është gati për çdo rast, sepse stërvitjen e bëjnë të gjithë njësoj. Sot (dje) jemi përballë një sfide, sepse Hoxha nuk ka arritur të rikuperohet. Është portier me eksperiencë dhe person pozitiv, megjithatë do të mundohemi ta bëjmë më të lehtë. Për këtë javë nuk do të jetë gati. **Ndërprerja e kampionatit i shërbeu skuadrës?**

Si ju duk paraqitja e Hebagj me ekipin përfaqësues?

Jam i kënaqur dhe i gëzuar që Hebagj ka shënuar kundër Maltës. Jam pyetur vazhdimisht për nevojën e një finalizuesi dhe gjithmonë kam shprehur besimin tek ata që kam. Sa herë vijnë nga Kombëtarja, vijnë më me besim. Hebagj është përkrahur dhe kemi akoma 25 ndeshje. **U ju vë në presion që luani**



më përpara se skuadrat e tjera?

Kanë pasur kërkesa ekstra trajnerët, por nuk kemi asnjë presion. Jemi të fokusuar.

Flamurtari është një kundërshtar direkt. Jemi të freskët. Çdo ndeshje është barometër. Në Vlorë do të shkojmë ta mbajmë vendin

SUPERLIGA		
JAVA E 14-TE		
TE PREMTEN		
Flamurtari-Partizani	18:00	
TE SHUTUNEN		
Tirana - Skënderbeu	14:00	
Teuta - Luftëtari	17:00	
TE DIELEN		
Kamza - Kukësi	14:00	
Laçi - Kastrioti	14:00	
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Partizani	13	31
Skënderbeu	13	29
Laçi	13	22
Teuta	13	22
Kukësi	13	21
Flamurtari	13	19
Luftëtari	13	13
Tirana	13	10
Kamza	13	8
Kastrioti	13	7

e parë.

Ndërhyrja në merkato, mund të ndikojë te lojtarët?

Ne e dimë ku na dhem. Jemi munduar t'i mbajmë

100% të karikuar lojtarët. Do të vijë momenti dhe bashkë me klubin do të vendosim. Çdo gjë është pozitive.

Keni interes për çfarë ndodh te Tirana?

Nuk kam interes për çfarë ndodh te Tirana. U pyeta edhe për Shkurtajn. Kam opinion pozitiv për të. Për Ngon u shpreha se ishte lojtar shumë i gjatë, hera e parë që e shihja. Nuk kemi biseduar me klubin për respekt të tij.

Telushi dhe Ibrahim i rrezikojnë nga të verdhat.

Do të japin 100%. Janë lojtarë që kanë peshë në ekip. Megjithatë janë gjëra që ndodhin. Ata kanë të verdha, por mund të ndodhë kështu që ne do të mundohemi t'i rikuperojmë. Në çdo ndeshje bëjmë 3 ndërime. 90% e grupit është aktivizuar. E rëndësishme është që grupi të funksionojë. Du-

het të marrim më të mirën. Shkojmë për të fituar, ne s'kemi rrugë tjetër. Uroj që të marrim maksimumin. Nëse diçka ndodh ndryshe, atëherë kemi edhe 70% të kampionatit.

Konkurrenca me Skënderbeun, sa presion do të ishte nëse nuk fitoni?

Nuk ka presion fare. Për fat të mirë e kemi kaluar këtë eksperiencë. Kemi genë në vend të parë dhe dolëm në të dytin. Kemi akoma shumë sfida dhe vetëm menaxhimi i mirë do të na ndihmojë. **A ju shqetëson që kemi futbollistë që kanë luajtur shumë?**

Disa futbollistë kanë pasur edhe detyra ekstra. Telushi Hila Ibrahim janë shtylla kurrizore e ekipit. Deri tani e kanë bërë shumë mirë. Kemi edhe djem të rinj, që kur të vijë shansi të japin atë çfarë duhet.

TRAJNERI I INTERIT

Spaleti: Me lojtarë si Modriç, mund të rivalizojmë Juventusin

Luçiano Spaleti në një intervistë për "Corriere della Sera" ka prekur disa tema që e rrethojnë skuadrën e Interit. Tekniku italian foli edhe për rivalët e Juventusit dhe mes të tjerash, u shpreh: "Armiku më i madh ishte mungesa e besimit. Unë u përpoqa t'i bëja lojtarët të kuptonin se të gjithë ne ishim përballur me të njëjtën pengesë dhe ne mund ta kapërcejmë atë të bashkuar, e jo si individë. Rezultatet pozitive në Ligën e Kampioneve na kanë dhënë shumë besim dhe entuziazëm. Ekipi por rritet dhe ky është objektivi im kryesor", u shpreh fillimisht trajneri i Interit. Më pas, Spaleti preku edhe rivalët e Juventusit, por dhe çështjen "Modriç": "Juventus ka dominuar në futbollin italian për disa vite dhe për ta arritur na duhen lojtarë të nivelit botëror si Luka Modriç", përfundoi Spaleti, i cili la të kuptohet se Interi do të insistojë sërish për mesfushorin kroat.

TRAJNERI SPANJOLL

Pep tremb Sitin: Herët a vonë do të drejtoj një Kombëtare


Aktualisht është shumë i lumtur te Mançester Siti. Është i lidhur me klubin anglez deri në vitin 2021 dhe sipas të gjitha gjaseve do të respektojë kontratën, pasi gjatë këtyre viteve misioni i tij është të fitojë sa më shumë tituj kampion në Angli, por gjithashtu të ngjisë Citizens në fronin e Europës duke triumfuar në UEFA Champions League. Pep Guardiola por shijon momentin por trajneri spanjoll në një intervistë nuk ka nguruar t'u përgjigjet



edhe pyetjeve që kanë të bëjnë me të ardhmen e tij. Pep nuk fshihet dhe e pra-

non se në të ardhmen e largët do t'i pëlqente të drejtonte një ekip përfaqësues pra të punonte në një kombëtare. "Do të kisha dëshirë të isha trajner i një ekipi kombëtar. Do të më pëlqente shumë. Do të ndodhë sepse do të jepte më tepër kohë të lirë. Do të kisha dëshirë të luaja më tepër golf, për momentin nuk kam kohë. Herët apo vonë do të ndodhë, nëse një ekip kombëtar do të trokase në derën time, do të pranoja me kënaqësi", deklaroi trajneri i Mançester Sitit.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Eshhtë babëzia.
8. Burton regjisor.
11. Skllavja e Abrahamit.
12. Një dite në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshhtë ankimim.
23. Pak elementare.
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrëhina për reparte fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Qytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.
36. I ka plasur të paturpit.

37. Janë legjendat.
38. Nuk ka akoma një bebe.
39. Fillojnë mirë.
40. Janë brrinjë në skuadër.
42. Shkrutet i shtati.
44. Ngjet edhe ajo e mirë
47. Mbahet në gisht.
48. Janë numrat 1, 3, 3...

VERTIKAL

1. Kanë shpatë të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla
5. Eshhtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryt të titujve
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rrëfimet e të pandehurit.
14. Janë penitj për gjergjef.
16. Mbarojnë fare.
18. Janë stitët e... provimëve.
20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tutje.
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
25. Eshhtë e akuzuara... injorante
26. Baldwin aktor
27. Një pjesë e kandidatëve.
28. Krenar pa gift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë pëshjtellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtar Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstre me litar.
46. Fillojnë lejen.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Satelit i Uranit.
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij
12. Në krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë iustrimet
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në modë.
30. Janë zyrtar... qeveritare
32. Me të nxjerrin trarë.
35. Një shkop, thupër.

VERTIKAL


37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
39. U thyen në Salamina.
40. Një raport shumë i ngushtë.
41. Nota e diapzonit.
42. Fund heroi.
43. Një top në rrjetë.
45. Gjysma alarmi.
46. Herët pa zë.
47. Sampras i tenisit.
48. Me to bëjnë triko.
49. Një gjuajtje fluturimthi në tenis.
50. Janë kokrrat e listit.

VERTIKAL


1. I famshëm ai i Sizifit.
2. Mund të jetë e hollë dhe therëse.
3. Fillojnë rastësisht.
4. Një pjesë e napolitanëve.
5. Janë situatat e rrezikshme para portave.
6. Mund të jenë kundërajrore.
7. Lindin në kokë.
8. Gjysmë shtegu.
9. Hiden të parat.
10. Eshhtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tutje.
15. Fundi i një samurai.
16. Mbyllin me epilog.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe
29. Hapat një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbur.
33. Vrau Hektorin.
34. Një film i rixhiruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktor.
41. Ullimann aktore.
43. Një brilantë moderne
44. Hotel pa kufij.
46. Ekstre në hall.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

4		2	9		5		1	6
9						3		
5				6	8	9		
2		6	4					1
	9				3	2		8
	5	3	6				4	
			1					
2		8	3					5
1			2	6				

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	7	8	3	1	2	4	5	9
2	9	1	8	4	5	6	7	3
3	5	4	9	6	7	8	1	2
8	3	5	1	9	4	2	6	7
1	4	7	2	3	6	9	8	5
9	6	2	7	5	8	3	4	1
4	1	3	5	8	9	7	2	6
5	2	6	4	7	3	1	9	8
7	8	9	6	2	1	5	3	4

Argëtim filozofik

-Për të arritur gjetjen e thelbit tonë të vërtetë, duhet që më parë të jetojmë të të shtatë mëkatet .

-Udhëtar, nëse nuk takon një shoqëruar më të mirë ose të ngjashëm me veten , vazhdon i bindur vetëm : nuk bëhet shoqëri me budallain .

-Ashtu si një shkëmb masiv nuk tundet nga era , ashtu edhe të mënçurit nuk lëkunden mes fajtimeve dhe lavdimeve .

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

K	3	U	L	2	T	14	4	9	7	4	19	M	A	S	H	U	R	K	A	I	R	A	K
8	10	5		1	4	12	2	6	7	5	10	E	S	T	E	R	A	D	H	U	N	A	
10	4	7		4	1	2	8	10	6	4	7	5	I	T	E	A	T	E	R	M	I	N	
18				1	7	5	8	9	4	2	10	4	E	R	A	P	O	L	A	R	T	A	
6	5	1		6	2	10	5	2	5		12	K	E	L	P	O	L	E	M	I	K	A	T
7	1			17	5		1	5	10	17	4	2	L		P	O	L	I	G	A	M	I	
2	5	10	17	4	2		4	10	6	15	5	E	T	A	P	I	K	A	T	R	E	L	
8		2	8	12		15		6	10	17	5	K	O	M	O	D	E	N	T	O	K	E	
18	10	5	16	19		6		4	8	5	10	1	T	R	I	S	E	T	M	N	U	N	
6		7	5		6	11	5	9	19	6	7	I	T	I	T	U	T	U	I	T	I	D	
4	11	4	7	6	2	6	1	5		7	17	6	K	A	D	E	T	K	O	S	H	L	E
12	5	2	5		12	1	6	15	4	2	8	E	T	I	K	S	E	K	S	E	R	E	T

- -Uji kanalizon burimet , harkëtarët lakojnë shigjetat ,
- marangozët përkulin drurin , të
- mënçurit vetëbinden .
- -Nuk kërkoi kompensim rilindjen në Qiell , por kërkoi të mirën e
- njerëzve , kërkoi
- të ridrejtoj ata që kanë humbur dritën e tyre , ata që jetojnë në
- errësirë dhe të zhduk
- nga bota të gjitha dhimbjet e vuajtjet .
- -Ai që vesh rrobën e verdhë pa u pastruar , pa
- fituar dominimin e vetes e pa
- kërkuar të vërtetën , është i padenjë për ta
- veshur atë .

Thënie të mënçura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQIVE TË NUMRIT TË KALUAR

P	E	T	R	I	K	A	S	P	A	K		
T	R	U	P	T	A	L	E	N	T	A		
T	B	E	L	S	A	N	D	O	K	A	N	
B	A	K	U	N	T	I	N	A	N	E	M	I
T	A	M	A	R	O	C	I	T	H	E		
P	A	T	I	O	N	E	A	O	D	R	E	
R	A	A	T	I	O	N	E	K	A	O	S	
K	E	L	S	A	P	E	T	E	A	L	E	A
E	L	S	A	N	A	L	A	R	O	N	E	
R	I	T	M	A	L	L	A	R	M	E	T	

FJALËKRYQI (1)



M	A	B	U	S	E	H	A	N	E	T		
O	R	E	K	S	B	D	E	M	O	N	I	
R	A	S	I	K	A	B	I	T	E	T	P	
I	B	A	S	T	E	R	E	R	T	O	N	I
A	T	K	I	M	B	O	I	N	R	K		
R	A	S	A	P	A	G	A	N	I	N	I	
T	A	V	E	R	R	A	D	O	M			
Y	M	A	J	A	S	I	A	N	E	T	J	A
H	A	R	A	K	I	R	I	E	R	I	T	
A	S	I	R	A	D	A	M	E	S			
S	H	A	M	A	T	A	L	O	T	U	S	

FJALËKRYQI (2)

